



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

**Raport përfundimtar për auditimin tematik në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për segmentin
“Rikonstruksioni i rrugës Uji i Ftohtë–Orikum dhe ndërtimi i dy By-pass-eve”, projekti
“Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale”**

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMI

AUDITIM TEMATIK MBI PËRPUTHSHMËRINË

NË

**Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për segmentin “Rikonstruksioni i rrugës Uji i
Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy By-pass-eve” , projekti “Konektiviteti i
Rrugëve Rajonale dhe Lokale”**

Tiranë, qershor 2022

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
II.	HYRJA	
1.	Titulli	13
2.	Marrësi	13
3.	Objektivat dhe qëllimi	13
4.	Identifikimi i çështjes	13
5.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim	14
6.	Përgjegjësitë e audituesve	14
7.	Kriteret e vlerësimit	14
8.	Standardet e auditimit	15
9.	Metodat e auditimit	16
10.	Dokumentimi i auditimit	16
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	17
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	17
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	17
2.1	Mbi konsultimet dhe dëgjesat publike me palët e interesit deri në miratimin e projektit óRikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy By në Pass në eveô	17
2.2	Për auditimin e përputhshmërisë së projektit me vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit óPër zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike dhe brezi bregdetarë nr. 1, datë 08.10.2013 dhe Vendimin nr. 5, datë 29.12.2014 óPër identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit Urbanë dhe Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Vlorë miratuar me Vendimin e KKT, nr. 1, datë 16.10.2017 óPër miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë, i rishikuar me Vendimin nr. 4 datë 17.05.2019 dhe nr. 3, datë 03.12.2020 óPër miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë	27
2.3	Mbi evidentimin nga projekti të subjekteve dhe kostove të zbatimit për subjektet pasuritë e të cilëve preken nga realizimi i projektit óRikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy By në Pass në eveô. Evidentimi i kostove financiare të shpronësimeve për interes publik në zbatim të ligjit nr. 861, datë 22.12.1999 óPër shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë prone private për interes publikô	31
2.4	Për auditimin e prokurimit të fondeve të kredisë si dhe ndjekjen e procedurave të Vlerësimit dhe Kontraktimit të fituesit, kontrata e punimeve civile me referencë DTM50123/W/2020/1 datë 07.12.2020 me OE A. në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, Projekti Rikonstruksioni i rrugës së Uji i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy Bypas në ve	34
2.5	Mbi zbatimin e kontratës së lidhur për mallra, shërbime dhe punime përfshirë verifikimin dhe inspektimin në terren të kontratës për segmentin	35

óRikonstruksioni i Rrugës Uji i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy By në pass
në eveô me mbikëqyrës të punimeve BOE óP.& E.ô, kontrata me referencë
DTM50123/W/2020/4, datë 28.12.2020 me vlerë 986,160 \$ me TVSH.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	38
V. ANEKSE	42

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Projekti “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale” është një Projekt i cili ka parashikuar ndërhyrje në rrjetin rrugor rajonal në zona me potencial bujqësor dhe turistik në të gjithë vendin dhe financohet nga Banka Botërore dhe BERZH me vlerë 100 milionë USD.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se kuadri ligjor kryesor mbi të cilin është realizuar ky Projekt është ligji nr. 54/2018 datë 23.07.2018 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale” dhe ligji nr. 44/2020 datë 23.04.2020 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri”. Projekti objekt auditimi Rikonstruksioni i rrugës së Uji i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy Bypas – ve është pjesë e listës së investimeve të cilat i janë shtuar projektit Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale në fazën e dytë të këtij projekti në kuadër të Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim datë 10.02.2020. Financimi është parashikuar të kryhet nga Transhi 1.

Për mbarëvajtjen e procesit është lidhur marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Vlorë, datë 30.04.2020 si përfituese përfundimtare ku janë përcaktuar detyrimet mes palëve. Kjo rrugë është parashikuar ti shërbejë jo vetëm banorëve të zonës midis Ujit të Ftohtë deri në Orikum, por edhe të gjithë turistëve vendas dhe të huaj të cilët frekuentojnë zonën bregdetare jugore të Shqipërisë. Projekti fillon në dalje të Tunelit tek Uji i Ftohtë, Vlorë dhe përfundon tek Marina në Orikum, me një gjatësi totale prej 10.75 km. Projekti parashikon ndërhyrje rikonstruksioni për rrugën ekzistuese nacionale Vlorë-Orikum dhe ndërtimin e dy by-pass-eve përpara dhe pas fshatit Radhimë. Për zbatimin e punimeve civile në këtë segment është lidhur kontrata e punimeve civile me referencë DTM50123/W/2020/1 datë 07.12.2020 me OE óA.-M.ô me vlerë 8,674,246.62 USD me TVSH me afat 12 muaj ndërsa për mbikëqyrjen e punimeve është lidhur kontrata me BOE óP.&E.ô sipas kontratës me referencë DTM50123/W/2020/4 datë 28.12.2020 me vlerë 986,160 USD me TVSH.

PËRSHKRIM I GJETJEVE

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion në lidhje me dëgjesa publike rezulton një listë me pjesëmarrës për takimin e zhvilluar në Bashkinë Vlorë datë 16.07.2020 me 14 pjesëmarrës dhe takimi është institucional pasi ka vetë pjesëmarrës nga institucionet Bashkia Vlorë dhe FSHZH dhe vetëm 2 pjesëmarrës nga fusha e biznesit. Nga FSHZH në lidhje me dëgjesat publike konstatohet se nuk janë kryer publikimet në regjistrin elektronik për konsultimet si dhe publikimi në programin e transparencës. Nuk ka një bazë të dhënash mbi procesin e konsultimit publik. Pas kërkesave të kryera nga grupi i	17-27	E lartë	FSHZH në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë të marrin masa të organizojnë konsultimet publike për óRikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë ñ Orikum dhe ndërtimi i dy By ñ Pass ñ eveó pjesë e projektit óKonektiviteti i

	auditimit nuk u vendos në dispozicion një informacion i qartë dhe i detajuar mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar. Për takimet e zhvilluara, që gjithsesi nuk mund të klasifikohen si dëgjesa publike, nuk ka procesverbale për dokumentimin e diskutimeve dhe pretendimeve të ngritura nga palët në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 <i>“Për njoftimin dhe konsultimin publik”</i>.			rrugëve rajonale dhe lokale me të gjitha etapat e parashikuara nga kuadri ligjor.
2.	Nga auditimi konstatohet se FSHZH nuk ka caktuar një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik për bashkërendimin dhe administrimin e punës. Nuk u vendos në dispozicion asnjë provë dokumentare mbi publikimin e njoftimit të konsultimit publik, marrjen e komenteve dhe rekomandimeve në asnjë formë. Nuk dokumentohet si janë njoftuar palët e interesit mbi arsyet dhe ndikimin që ka projekti, afati, vendi dhe mënyra se si mund të dërgohen rekomandimet, adresa e kontaktit të koordinorit për njoftimin dhe konsultimin publik në kundërshtime nenet 10, 11, 13 të ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 <i>“Për njoftimin dhe konsultimin publik”</i>	17-27	E lartë	FSHZH në bashkëpunim me institucionet përfituese të projekteve të marrin masa që të ngrejne strukturat përkatëse për zhvillimin e konsultimeve publike duke mirë informuar palët e interesit dhe duke reflektuar dhe zgjidhur problematikat e komunitetit.
3.	Deri në fund të periudhës objekt auditimi (datë 29.04.2022) nuk ka një projekt përfundimtar të pranuar dhe miratuar nga FSHZH (zhvillues i projektit) dhe Bashkia Vlorë (përfitues) por ka një projekt që është në proces ndryshimi ku është evidentuar një gjurmë dhe një listë me prona që preken nga projekti. Në raportin e hartuar nga vlerësuesja e pasurive të paluajtshme zj. M. F. janë evidentuar pronat dhe vlera koresponduese për shpronësim. Impementimi i projektit óRikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy By në Pass në eve të prek pronat e Bashkisë Vlorë në zonat Kadastrale 8602 (Vlorë) dhe 3140 (Radhimë), Njësia Administrative Orikum. Për të minimizuar efektet e shpronësimit, ndërtimi i rrugës, që do të mundësohet nga zbatimi i projektit, ka bërë të mundur shmangien e pronave private të zëna nga ndërtesa banimi dhe/ose objekte biznesi aty ku ka qenë teknikisht e mundur. Kuadri ligjor në fuqi për zbatimin e projektit parashikon që personat e prekur nga projekti do të kompensohen për çdo humbje të aseteve fizike, të ardhurave dhe fitimeve që rrjedhin nga realizimi i këtij investimi, nëse këto humbje janë të përkohshme ose të përhershme. Megjithatë, dëshmitë e mbledhura nga vizitat në	31-34	E lartë	FSHZH në bashkëpunim me të gjithë institucionet e përfshira në procesin e shpronësimeve të marrin masa që të evidentohen lista e plotë e pronarëve, vlera përkatëse dhe të nisin menjëherë hapat ligjor për përfundimin e procesit të shpronësimeve dhe kompensimin e pronarëve.

	terren kanë treguar se ndërtimi i rrugëve prek kryesisht parcelat në pronësi publike, tokat bujqësore, vegjetacionin dhe prodhimin në këto toka. Zbatimi i projektit do të ndikojë drejtpërdrejt tek personat që preken nga projekti sepse do të shpronësohen për një sipërfaqe të caktuar të pronës së tyre. Shpronësimi kryhet për interes publik dhe toka bujqësore e marrë do të përdoret për ndërtimin dhe vënien në funksion të objektit “Rikonstruksioni i rrugës ekzistuese Vlorë-Orikum dhe i dy By-pass-eve”. Në sipërfaqen 47 311.14 m² janë marrë në konsideratë sipërfaqja 15 695.44 m² - By Pass 1 dhe 31 615.70 m² By Pass2. Nga vlerësimi i kryer deri në këtë pikë të projektit rezulton se në total nga ndërtimi i dy By-Pass në veç preken 50 prona, specifikisht 22 prona nga By në pass 1 dhe 28 prona nga By në pass 2. Aneksi nr. 3.2 óLista e pronave që preken nga projekti dhe që do të shpronësohenó <u>Kosto totale e shpronësimit është 567,733,680 lekë ku përveç vlerës së tokës futen edhe kosto e produkteve bujqësore, si dhe zhvlerësimi i pronës nga shpronësimi i një pjese të saj.</u>			
4.	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për zbatimin e punimeve civile në këtë segment është lidhur kontrata e punimeve me referencë DTM50123/e /2020/1 datë 07.12.2020 me OE óA.-M.ó me vlerë 8,674,246.62 USD me TVSH me afat 12 muaj ndërsa për mbikëqyrjen e punimeve është lidhur kontrata me BOE óP.&E.ó sipas kontratës me referencë DTM50123/e /2020/4 datë 28.12.2020 me vlerë 986,160 USD me TVSH. Aktualisht, pas ndryshimit të projektit fillestar të dorëzuar nga ana e projektuesit BOE I.& A. 4 & S. C., projekti i ri nuk disponon akoma leje ndërtimi, nuk është dorëzuar sheshi i ndërtimit, punimet në terren nuk kanë filluar dhe janë ende në proces procedurat për shpronësimet. Në lidhje me ndryshimet e projektit nga ana e subjektit të audituar u vu në dispozicion dokumentacioni si më poshtë: - Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 9879 prot., datë 15.11.2018 dhe në FSHZH me nr. 1518 prot., 20.11.2018, Bashkia Vlorë i është drejtuar FSHZH dhe projektuesit me një shkresë ku i ka përcjellë projekt në propozimet në lidhje me ndërtimin e dy Bypass në veç në rrugën Radhimë në Orikum. Sipas këtij projekt propozimi është rishikuar gjurma e propozimit fillestar duke marrë parasysh parcelat ekzistuese, gjurmët e rrugëve ekzistuese, njësitë strukturore referuar PPV si dhe relacioneve shpjeguese. Sipas kësaj shkresë është cituar fakti se Bashkia Vlorë e ka bërë këtë projekt propozim në bashkëpunim me grupet e interesit, bizneset	35-37	E lartë	Nga ana e FSHZH, në zbatim të Nenit III Ligji nr. 44/2020 datë 23.04.2020 dhe në cilësinë e <i>Entit Zbatues të Projektit</i> të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme kryesisht ato në drejtëm të bashkëpunimit me Bashkinë Vlorë, sipas Marrëveshjes së lidhur me këtë qëllim mes FSHZH dhe Bashkisë Vlorë në datë 30.04.2020.

	që operojnë në atë zonë, si palë të interesuara; - Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 6131 prot., datë 22.07.2020 dhe në FSHZH me nr. 1635 prot., 24.07.2020 Bashkia Vlorë i ka kërkuar FSHZH rishikimin e projektit me qëllim reflektimin e projekt-propozimeve të bëra nga kjo NJV e cila sipas Bashkisë është kryer në bashkëpunim me grupet e interesit, bizneset që operojnë në atë zonë, si palë të interesuara; - Me shkresën e administruar në FSHZH me nr. 2171 prot., datë 22.09.2020 i është bërë me dije Bashkisë Vlorë fakti mbi vonesat në drejtim të Planit të Veprimit të Risistemimit për rrugën Uji i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy Bypass në të. Edhe pas një takimi të kryer në datë 16.07.2020 të kryer në Bashkinë Vlorë me përfaqësues të Bashkisë dhe komunitetit nuk ka asnjë rezultat mbi marrjen e titujve të pronësisë nga ASHK për këtë arsye është kërkuar një angazhim shtesë nga ana e Njesisë Vendore; - Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 602/1 prot., datë 19.01.2021 dhe në FSHZH me nr. 342 prot., 22.01.2021, Bashkia Vlorë i ka kërkuar FSHZH rishikimin e projektit me qëllim reflektimin e projekt-propozimeve të bëra nga kjo NJV e cila sipas Bashkisë është kryer në bashkëpunim me grupet e interesit, bizneset që operojnë në atë zonë, si palë të interesuara duke kërkuar spostimin e gjurmës së Bypass në it si dhe spostimin e rreth-rrrotullimit i cili sipas Bashkisë Vlorë është jo funksional. Kësaj shkresë i është bashkëlidhur edhe ankesa e bërë nga ana e nga një banori, prona e të cilit preket nga kalimi i gjurmës së projektit. - Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 1899/1 prot., datë 19.02.2021 dhe në FSHZH me nr. 342/1 prot., 01.03.2021, Bashkia Vlorë i ka kërkuar FSHZH rishikimin e projektit me qëllim reflektimin e projekt-propozimeve të bëra nga kjo NJV e cila sipas Bashkisë është kryer në bashkëpunim me grupet e interesit si dhe pronarëve legjitimë në atë zonë duke kërkuar spostimin e gjurmës së projektit pasi ajo e miratuar aktualisht në momentin e shkresës ka qenë e tillë që sipas Bashkisë ndan në mes parcelat dhe sjell një kosto të madhe edhe për shpronësimin e tyre. Gjithashtu është përmendur fakti se rreth-rrrotullimi i parashikuar është jo funksional dhe nuk zgjidh trafikun e mjeteve. Kësaj shkresë i është bashkëlidhur edhe ankesa e bërë nga ana e nja grupi banorësh të Radhimës, prona e të cilëve preket nga kalimi i gjurmës së projektit; - Me shkresën e administruar në FSHZH me nr. 342/2 prot., datë 04.03.2021 është dorëzuar			
--	---	--	--	--

	projekti nga ana e Projektuesit sipas kërkesave të bëra nga ana e Bashkisë Vlorë. Sipas të gjithë dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe pretendimeve të subjektit të audituar rezulton se është aplikuar për leje ndërtimi por kjo leje nuk është miratuar akoma për shkak të problemeve me pronat dhe aktualisht disponohet vetëm një Draft i miratimit të lejes. (Shiko Aneksin nr. 2.1). Për rrjedhojë rezulton se prej mungesës së ndjekjes në mënyrën e duhur të hapave për realizimin e projektit nga ana e FSHZH, konkretisht të atyre në drejtim të bashkëpunimit me Bashkinë Vlorë për identifikimin e saktë dhe në kohë të gjurmës së projektit janë shkaktuar vonesa në realizimin e projektit sipas marrëveshjes së financimit të ratifikuar me ligj. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 44/2020 datë 23.04.2020 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri”, neni III Ekzekutimi i Projektit.			
5.	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se aktualisht, pas lidhjes së kontratës nga ana e kontraktorit është paraqitur për pagesë vetëm një situacion pjesor i gushtit të vitit 2021 i cili i takon pagesës paradhënie <i>Advance Payment</i> në shumën prej 1,445,707.77 USD pa TVSH, ose 1,734,849.324 USD me TVSH. Nga kjo i është paguar OE <u>vetëm pagesa e vlerës së TVSH në masën 30,258,663 lekë, ose vlera koresponduese e shumës prej 289,141.55 USD</u>. Pas ndryshimit të projektit fillestar të dorëzuar nga ana e projektuesit BOE I. & A. & S., rezulton se objekti nuk disponon akoma leje ndërtimi, nuk është dorëzuar sheshi i ndërtimit, punimet në terren nuk kanë filluar dhe janë ende në proces procedurat për shpronësimet. Aktualisht kontraktorit nuk i është paguar shuma prej 1,445,707.774, situatë kjo e cila e ekspozon ndjeshëm FSHZH ndaj riskut të paraqitjes së ankesave nga ana e Kontraktorit për vonesa në kryerjen e pagesës sipas kushteve të kontratës. Për rrjedhojë rezulton se prej mungesës së ndjekjes në mënyrën e duhur të hapave për realizimin e projektit nga ana e FSHZH, konkretisht të atyre në drejtim të bashkëpunimit me Bashkinë Vlorë për identifikimin e saktë dhe në kohë të gjurmës së projektit është rritur ekspozimi i FSHZH ndaj riskut të paraqitjes për ankesave për vonesa në kryerjen e pagesave nga ana e kontraktorit duke rritur kështu mundësitë e krijimit të situatave jo të favorshme për financat e Projektit dhe të vet	35-37	E lartë	Nga ana e FSHZH, në zbatim të Nenit III Ligji nr. 44/2020 datë 23.04.2020 dhe në cilësinë e <i>Entit Zbatues të Projektit</i> të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar një menaxhim të konsoliduar financiar me qëllim përmbushjen e dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

	FSHZH.			
--	--------	--	--	--

KONKLUZION DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Në vlerësimin tonë, rezultati i auditimit për çështjet e përputhshmërisë së veprimtarisë së Fondit Shqiptar të Zhvillimit për segmentin óRikonstruksioni i Rugës Uji i Ftohtë ñ Orikum dhe ndërtimi i dy By ñ pass ñ eveô pjesë e Projektit “Konektiviteti i Rugëve Rajonale dhe Lokale”, me fokus çështjet si më poshtë:

- Ankesën e Kryeplakut të Fshatit Rradhimë z. H. H., dërguar në KLSH sipas shkresës me nr. 265 prot., datë 03.03.2022 me objekt “Kërkesë për trajtim dhe marrjen e masave të menjëhershme parandaluese” nga ana e Institucionit të Presidencës së Republikës;
- Konsultimet dhe dëgjesat publike me palët e interesit deri në miratimin e projektit;
- Përputhshmërinë e projektit me vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit si dhe Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Vlorëme ndryshime;
- Procedurat e shpronësimeve;
- Procedurat e ndjekura për prokurimet dhe zbatimet e kontratave;

rezulton se, aktiviteti i FSHZH si subjekt i audituar sipas Programit të Auditimit nr. 265/2 prot., datë 11.03.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë auditim, konkretisht ato të cilat kanë të bëjnë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator që rregullon veprimtarinë e çështjeve si më sipër. Ky konkluzion arrihet mbështetur në faktet dhe rezultatet e auditimit si më poshtë:

1. Në lidhje me dëgjesat publike rezulton vetëm një listë me 14 pjesëmarrës për takimin e zhvilluar në Bashkinë Vlorë datë 16.07.2020 i cili ka qenë institucional pasi ka vetëm pjesëmarrës nga institucionet Bashkia Vlorë dhe FSHZH si dhe vetëm 2 personanga fusha e biznesit;
2. Nga FSHZH nuk janë kryer publikimet e dëgjesave publike në regjistrin elektronik për konsultimet si dhe publikimi në programin e transparencës;
3. Nuk ka një bazë të dhënash mbi procesin e konsultimit publik;
4. Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion një informacion i qartë dhe i detajuar mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri tek miratimi i aktit përfundimtar dhe takimet e zhvilluara, që gjithsesi nuk mund të klasifikohen si dëgjesa publike, nuk kanë procesverbale për dokumentimin e diskutimeve dhe pretendimeve të ngritura nga palët;
5. FSHZH nuk ka caktuar një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik për bashkërendimin dhe administrimin e punës dhe nga ana e subjektit të audituar FSHZH, nuk u vendos në dispozicion asnjë provë dokumentare mbi publikimin e njoftimit të konsultimit publik, si dhe asnjë formë e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve. Gjithashtu, nuk dokumentohet se si janë njoftuar palët e interesit mbi arsyet dhe ndikimin që ka projekti, afati, vendi dhe mënyra se si mund të dërgohen rekomandimet, adresa e kontaktit të koordinators për njoftimin dhe konsultimin publik;
6. Aktualisht nuk ka një projekt përfundimtar të pranuar dhe miratuar nga FSHZH (zhvillues i projektit) dhe Bashkia Vlorë (përfitues) por ka një projekt që është në proces ndryshimi ku është evidentuar një gjurmë dhe një listë me prona që preken nga projekti;
7. Deri në fund të periudhës objekt auditimit, nga ana e kontraktorit është paraqitur për pagesë vetëm një situacion pjesor i gushtit të vitit 2021 i cili i takon pagesës paradhënie *Advance*

Payment në shumën prej 1,445,707.77 USD pa TVSH, ose 1,734,849.324 USD me TVSH. Nga kjo shumë, i është paguar OE vetëm pagesa e vlerës së TVSH në masën 30,258,663 lekë, ose vlera koresponduese e shumës prej 289,141.55 USD. Pas ndryshimit të projektit fillestar të dorëzuar nga ana e projektuesit BOE I. & A. & S. C., rezulton se objekti nuk disponon akoma leje ndërtimi, nuk është dorëzuar sheshi i ndërtimit, punimet në terren nuk kanë filluar dhe janë ende në proces procedurat për shpronësimet dhe kontraktorit nuk i është paguar shuma prej 1,445,707.774, situatë kjo e cila e ekspozon ndjeshëm FSHZH ndaj riskut të paraqitjes së ankesave nga ana e Kontraktorit për vonesa në kryerjen e pagesës sipas kushteve të kontratës;

8. Si pasojë e sa më sipër rezulton se edhe pse është aplikuar për leje ndërtimi, kjo leje nuk është miratuar akoma për shkak të problemeve me pronat.

KONKLuzion I AUDITIMIT

Konkluzion i auditimit tematik mbi përputhshmërinë

KLSH ka kryer auditim tematik mbi përputhshmërinë në Fondin Shqiptar të Zhvillimit për segmentin óRikonstruksion i Rugës Ujë i Ftohtë ñ Orikum dhe Ndërtimi i dy By-pass^{eve}ô, projekti óKonektiviteti i Rugëve Rajonale dhe Lokaleô për periudhën nga fillimi i Projektit deri më 28.02.2022 me fokus kryesor çështjet si më poshtë:

- Ankesën e Kryeplakut të Fshatit Radhimë z. H . H., dërguar në KLSH sipas shkresës me nr. 265 prot., datë 03.03.2022 me objekt “*Kërkesë për trajtim dhe marrjen e masave të menjëhershme parandaluese*” nga ana e Institucionit të Presidencës së Republikës;
- Konsultimet dhe dëgjuesat publike me palët e interesit deri në miratimin e projektit;
- Përputhshmërinë e projektit me vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit si dhe Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Vlorë me ndryshime;
- Procedurat e shpronësimeve;
- Procedurat e ndjekura për prokurimet dhe zbatimet e kontratave;

Në përfundim të punës audituese, pas marrjes së dëshmive të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, rezultuan mos përputhje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi në lidhje me çështjet të cilat ishin në fokus të këtij auditimi.

Baza për konkluzionin

Bazuar në punën e kryer të auditimit, evidencat e marra për veprimtarinë në Fondin Shqiptar të Zhvillimit për segmentin óRikonstruksion i Rugës Ujë i Ftohtë ñ Orikum dhe Ndërtimi i dy By-pass^{eve}ô, projekti óKonektiviteti i Rugëve Rajonale dhe Lokaleô, rezultuan devijime materiale të përhapura si më poshtë:

- Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion në lidhje me dëgjuesat publike rezulton një listë me pjesëmarrës për takimin e zhvilluar në Bashkinë Vlorë datë 16.07.2020 me 14 pjesëmarrës dhe takimi është institucional pasi ka vetë pjesëmarrës nga institucionet Bashkia Vlorë dhe FSHZH dhe vetëm 2 pjesëmarrës nga fusha e biznesit.
- Nga FSHZH në lidhje me dëgjuesat publike konstatohet se nuk janë kryer publikimet në regjistrin elektronik për konsultimet si dhe publikimi në programin e transparencës. Nuk ka një bazë të dhënash mbi procesin e konsultimit publik. Pas kërkesave të kryera nga grupi i auditimit nuk u vendos në dispozicion një informacion i qartë dhe i detajuar mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.

- Për takimet e zhvilluara, që gjithsesi nuk mund të klasifikohen si dëgjesa publike, nuk ka procesverbale për dokumentimin e diskutimeve dhe pretendimeve të ngritura nga palët.
- Nga auditimi konstatohet se FSHZH nuk ka caktuar një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik për bashkërendimin dhe administrimin e punës.
- Nuk u vendos në dispozicion asnjë provë dokumentare mbi publikimin e njoftimit të konsultimit publik, marrjen e komenteve dhe rekomandimeve (në asnjë formë).
- Nuk dokumentohet si janë njoftuar palët e interesit mbi arsyet dhe ndikimin që ka projekti, afati, vendi dhe mënyra se si mund të dërgohen rekomandimet, adresa e kontaktit të koordinorit për njoftimin dhe konsultimin publik në kundërshtime nenet 10, 11, 13 të ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 për njoftimin dhe konsultimin publik.
- Deri në fund të periudhës objekt auditimi (datë 29.04.2022) nuk ka një projekt përfundimtar të pranuar dhe miratuar nga FSHZH (zhvillues i projektit) dhe Bashkia Vlorë (përfitues) por ka një projekt që është në proces ndryshimi ku është evidentuar një gjurmë dhe një listë me prona që preken nga projekti.

Kosto totale e shpronësimit është 567,733,680 lekë ku përveç vlerës së tokës futen edhe kosto e produkteve bujqësore, si dhe zhvlerësimi i pronës nga shpronësimi i një pjese të saj.

- Pas lidhjes së kontratës nga ana e kontraktorit është paraqitur për pagesë vetëm një situacion pjesor i gushtit të vitit 2021 i cili i takon pagesës paradhënie Advance Payment në shumën prej 1,445,707.77 USD pa TVSH, ose 1,734,849.324 USD me TVSH. Nga kjo i është paguar OE vetëm pagesa e vlerës së TVSH në masën 30,258,663 lekë, ose vlera korresponduese e shumës prej 289,141.55 USD. Pas ndryshimit të projektit fillestar të dorëzuar nga ana e projektuesit BOE I.& A.& S. C., rezulton se objekti nuk disponon akoma leje ndërtimi, nuk është dorëzuar sheshi i ndërtimit, punimet në terren nuk kanë filluar dhe janë ende në proces procedurat për shpronësimet. Aktualisht kontraktorit nuk i është paguar shuma prej 1,445,707.774, situatë kjo e cila e ekspozon ndjeshëm FSHZH ndaj riskut të paraqitjes së ankesave nga ana e Kontraktorit për vonesa në kryerjen e pagesës sipas kushteve të kontratës. Për rrjedhojë rezulton se prej mungesës së ndjekjes në mënyrën e duhur të hapave për realizimin e projektit nga ana e FSHZH, konkretisht të atyre në drejtim të bashkëpunimit me Bashkinë Vlorë për identifikimin e saktë dhe në kohë të gjurmës së projektit është rritur ekspozimi i FSHZH ndaj riskut të paraqitjes për ankesave për vonesa në kryerjen e pagesave nga ana e kontraktorit duke rritur kështu mundësitë e krijimit të situatave jo të favorshme për financat e Projektit dhe të vet FSHZH.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Stafi drejtues është përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve dhe funksioneve të strukturës në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe për përdorimin e këtyre fondeve me ekonomicitet eficient dhe efektivitet etj.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH

Përgjegjësia jonë është që nëpërmjet auditimit të realizuar:

- Të vlerësojmë nëse informacionet mbi çështjet e audituara janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (ISSAI 4000), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime

dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Ne si Auditues Shtetëror shprehemi me një konkluzion mbi përputhshmërinë e çështjeve të cilat ishin fokus i këtij auditimi tematik. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryejmë në mënyrë efektive auditimin (ISSAI 1300)

-Të vlerësojmë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (ISSAI 1500, ISA 300).

-Të kryejmë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 óDeklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-tô, si dhe ISSAI 30 óKodi Etikô, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e konkluzionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e konkluzionit të auditimit.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 265/2 prot., datë 11.03.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 15.03.2022 deri më datë 30.04.2022, në subjektin Fondi Shqiptar i Zhvillimit, për segmentin óRikonstruksioni i Rrugës Uji i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy By në pass në eveó Projekti óKonektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokaleó, u krye auditimi tematik i përputhshmërisë nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. I. S., Përgjegjëse Grupi
2. J. H., Kryeauditues

1. Titulli:Projekt Raport auditimi tematik mbi përputhshmërinë e Projektit óKonektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokaleó për Segmentin óRikonstruksioni i Rrugës Uji i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy By në pass në eveó

2. Marrësi:Fondi Shqiptar i Zhvillimit

3. Objektivat dhe qëllimi :

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator.

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Nëpërmjet kryerjes së këtij auditimi KLSH synon të promovojë:

- Transparencën, duke ofruar raport të besueshëm për fondet nëse janë administruar sipas një procesi të rregullt është respektuar kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi;
- Përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre;

-Qeverisjen e mire, duke identifikuar dobësitë dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm, si dhe duke marrë parasysh riskun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë.

Auditimi ka për qëllim ***promovimin e transparencës*** duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë raportuar siç kërkohet si dhe nëse janë arritur apo jo objektivat e Projektit. Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim ***promovimin epërgjegjshmërisë*** ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.

4. Identifikimi i çështjes:

Mbi konsultimet dhe dëgjuesat publike me palët e interesit deri në miratimin e projektit óRikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy By në Pass në eveó.

Për auditimin e përputhshmërisë së projektit me vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit Për zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike dhe brezi bregdetarë nr. 1, datë 08.10.2013 dhe Vendimin nr. 5, datë 29.12.2014 Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit Urban dhe Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Vlorë miratuar me Vendimin e KKT, nr. 1, datë 16.10.2017 Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë dhe i rishikuar me Vendimin nr. 4 datë 17.05.2019 dhe nr. 3, datë 03.12.2020 Për miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë

Mbi evidentimin nga projekti të subjekteve dhe kostove të zbatimit për subjektet pasuritë e të cilëve preken nga realizimi i projektit Rikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy By në Pass në eve. Evidentimi i kostove financiare të shpronësimeve për interes publik në zbatim të ligjit nr. 861, datë 22.12.1999 Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë prone private për interes publik

Për auditimin e prokurimit të fondeve të kredisë si dhe ndjekjen e procedurave të Vlerësimit dhe Kontraktimit të fituesit, kontrata e punimeve civile me referencë DTM50123/W/2020/1 datë 07.12.2020 me OE A. në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, Projekti Rikonstruksioni i rrugës së Uji i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy Byas në ve

Mbi zbatimin e kontratës së lidhur për mallra, shërbime dhe punime përfshirë verifikimin dhe inspektimin në terren të kontratës për segmentin Rikonstruksioni i Rrugës Uji i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy By në pass në eve me mbikëqyrës të punimeve BOE OP& E.ë, kontrata me referencë DTM50123/W/2020/4, datë 28.12.2020 me vlerë 986,160 \$ me TVSH.

5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Strukturat drejtuese kanë për detyrë të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

6. Përgjegjësitë e audituesve:

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti përputhet, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregulloret, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen dhe zbatohen etj.;

- njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);

- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

7. Kriteret e vlerësimit:

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *ó*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitó

Rregullore e Brendshme *ó*Mbi organizimi dhe funksionimit administrativ të KLSH-sëó miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015, e ndryshuar

Rregullore *ó*Mbi procedurat e auditimit të KLSHó, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së.

Praktikat më të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë i Gjykatës Evropiane të Auditimit, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI *ó*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi auditimin e përputhshmërisëó, Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë i miratuar nga KLSH.

Marrëveshja e Huas Nr. 8850-Al datë 05.06.2018, me vlerë 50 mln \$ ndërmjet IBRD dhe Qeverisë Shqiptare për projektin *ó*Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokaleó

Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar;

Ligji për ratifikimin e marrëveshjes së financimit;

Ligji nr. 8890, datë 23.01.2003 *ó*Për vlerësimin e ndikimit në mjedisó, i ndryshuar;

Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*;

VKM nr. 116, datë 24.02.1997 *ó*Për kompetencat, procedurat, nënshkrimet, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huajaó;

VKM nr. 452, datë 01.07.1998 *ó*Për disa masa në përmirësimin e punës për financimin e projekteve që financohen nga donatorët e huajó;

Udhëzimi nr. 3, datë 15.02.2001 *ó*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitó, i ndryshuar;

Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 *ó*Për zbatimin e punimeve të ndërtimitó.

8. Standardet e auditimit:

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, si dhe mbështetur në:

- Kërkesat e Kushtetutës së Shqipërisë (Pjesa XIV, nenet 162 ñ 165);

- Ligjin nr. 154/2014 *ó*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitó;

- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;

- ISSAI 400- Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;

- ISSAI 4000- Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisëó;

- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;

- ISSAI 1530 (ISA 530)- Objektivi i audituesit është të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi;

- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;

- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI *ó*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisëó;

- si dhe në praktikat më të mira të fushës.

9. Metodat e auditimit

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar:

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

10. Dokumentimi i auditimit

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me nëpunësit e FSHZH, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me akt-konstatimet dhe më pas shqyrtimin e observacione ve të subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt Raporti.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Projekti “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale” është një Projekt i cili ka parashikuar ndërhyrje në rrjetin rrugor rajonal në zona me potencial bujqësor dhe turistik në të gjithë vendin dhe financohet nga Banka Botërore dhe BERZH me vlerë 100 milionë USD.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se kuadri ligjor kryesor mbi të cilin është realizuar ky Projekt është ligji nr. 54/2018 datë 23.07.2018 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale” dhe ligji nr. 44/2020 datë 23.04.2020 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri”. Projekti objekt auditimi Rikonstruksioni i rrugës së Uji i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy Bypas – ve është pjesë e listës së investimeve të cilat i janë shtuar projektit Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale në fazën e dytë të këtij projekti në kuadër të Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim datë 10.02.2020. Financimi është parashikuar të kryhet nga Transhi 1.

Për mbarëvajtjen e procesit është lidhur marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Vlorë, datë 30.04.2020 si përfutuese përfundimtare ku janë përcaktuar detyrimet mes palëve. Kjo rrugë është parashikuar ti shërbejë jo vetëm banorëve të zonës midis Ujit të Ftohtë deri në Orikum, por edhe të gjithë turistëve vendas dhe të huaj të cilët frekuentojnë zonën bregdetare jugore të Shqipërisë. Projekti fillon në dalje të Tunelit tek Uji i Ftohtë, Vlorë dhe përfundon tek Marina në Orikum, me një gjatësi totale prej 10.75 km. Projekti parashikon ndërhyrje rikonstruksioni për rrugën ekzistuese nacionale Vlorë-Orikum dhe ndërtimin e dy by-pass-eve përpara dhe pas fshatit Radhimë. Për zbatimin e punimeve civile në këtë segment është lidhur kontrata e punimeve civile me referencë DTM50123/W/2020/1 datë 07.12.2020 me OE óA.-M.ó me vlerë 8,674,246.62 USD me TVSH me afat 12 muaj ndërsa për mbikëqyrjen e punimeve është lidhur kontrata me BOE óP.&E.ó sipas kontratës me referencë DTM50123/W/2020/4 datë 28.12.2020 me vlerë 986,160 USD me TVSH.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Mbi konsultimet dhe dëgjесat publike me palët e interesit deri në miratimin e projektit “Rikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy By – Pass – eve”

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit nr. 265/2, datë 15.03.2022, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Ligji nr. 44/2020, datë 23.4.2020 óPër ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale në Shqipëri”.
- Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe Bashkisë Vlorë, datë 30.04.2020.
- Ankesat e adresuara në FSHZH dhe përgjigjet e tyre.
- Foto të aktiviteteve të realizuara.
- Etj.

Nga auditimi u konstatua se:

Për realizimin e këtij nënprojektit *“Rikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy by – pass – eve”* pjesë e projektit *“Konektiviteti i rrugëve rajonale dhe lokale”* është lidhur Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe Bashkisë Vlorë, datë 30.04.2020. Financimi i nënprojektit është realizuar me hua nga BERZH (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) nëpërmjet marrëveshjes së huas datë 10.02.2020 ratifikuar me Ligjin nr. 44/2020, datë 23.4.2020 *“Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet republikës Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për rindërtim dhe zhvillim për financimin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale në Shqipëri”*.

Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet fondit shqiptar të zhvillimit dhe Bashkisë Vlorë, datë 30.04.2020 janë përcaktuar detyrimet mes palëve ku pjesa e konsultimit publik dhe dëgjësive të qytetarëve i është përcaktuar Bashkisë Vlorë, kjo bazuar në nenin 3, *“Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë”*, konkretisht:

“Bashkia mban mbledhje periodike me qytetarët dhe ndan informacione mbi objektivat e nënprojektit, avantazhet dhe progresin e arritur gjatë zbatimit të nënprojektit”.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se me datë 12.01.2018 është lidhur mes FSHZH e përfaqësuar nga ana e ish në Titullarit të AK z. B. B. dhe BOE I.& A.& S. C. me objekt Hartimi i projekt-zbatimit dhe preventivit për rehabilitimin e rrugës ekzistuese Uji i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimin e dy by-pass në eve një kontratë, në zbatim të marrëveshjes kuadër të lidhur me këtë BOE, me vlerë 22,236,120 lekë me TVSH me afat 4 muaj.

Titulli i gjetjes:	Mangësi në lidhje me dokumentimin e dëgjësive publike.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion në lidhje me dëgjësia publike rezulton një listë me 14 pjesëmarrës për takimin e zhvilluar në Bashkinë Vlorë datë 16.07.2020. Takimi ka qenë institucional pasi ka vetëm pjesëmarrës nga institucionet Bashkia Vlorë dhe FSHZH dhe vetëm 2 nga fusha e biznesit. Nga FSHZH në lidhje me dëgjësat publike konstatohet se nuk janë kryer publikimet në regjistrin elektronik për konsultimet si dhe publikimi në programin e transparencës. Nuk ka një bazë të dhënash mbi procesin e konsultimit publik. Pas kërkesave të kryera nga grupi i auditimit nuk u vendos në dispozicion një informacion i qartë dhe i detajuar mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri tek miratimi i aktit përfundimtar. Për takimet e zhvilluara, që gjithsesi nuk mund të klasifikohen si dëgjësia publike, <u>nuk ka procesverbale për dokumentimin e diskutimeve dhe pretendimeve të ngritura nga palët.</u>
Kriteri:	Pika 1 e nenit 6 të ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 <i>“Për njoftimin dhe konsultimin publik”</i>, konkretisht: <i>“Organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë:</i> <i>a) publikimin në regjistrin elektronik të projekt-aktit, të njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projekt-akteve;</i> <i>b) publikimin në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të</i>

	<i>drejtën e informimit”, të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, në kuptim të këtij ligji;</i> <i>c) dhënien e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar</i> <i>“Organi publik, pas publikimit të njoftimit në regjistrin elektronik, mund të organizojë konsultime të drejtpërdrejta dhe takime publike me palët e interesuara. Konsultimet e drejtpërdrejta dhe takimet publike me palët e interesuara dokumentohen me procesverbal. Procesverbali i takimeve publike, të organizuara sipas këtij ligji, është dokument zyrtar. Për konsultime veçanërisht të rëndësishme, si dhe kurdo që është e mundur, me vendim të organit publik, takimet publike transmetohen në median audiovizive publike për të mundësuar ndjekjen e tyre nga publiku i gjerë.”</i>
Ndikimi:	Komuniteti nuk ka pranuar gjurmën e projektit dhe pwr rrjedhojw kanw rezultuar ankesa.
Shkaku	Mos kryerja e dëgjësive publike.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	FSHZH në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë të marrin masa të organizojnë konsultimet publike për óRikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë ñ Orikum dhe ndërtimi i dy By ñ Pass ñ eveô pjesë e projektit “Konektiviteti i rrugëve rajonale dhe lokale” me të gjitha etapat e parashikuara nga kuadri ligjor. FSHZH në bashkëpunim me institucionet përfituese të projekteve të marrin masa që të kryejnë konsultimet publike me të gjitha etapat e parashikuara në kuadrin ligjor me qëllim që projektet të jenë të pranuar nga komuniteti si dhe të mos ketë vonesa gjatë implementimit të tyre.
Afati:	<i>Menjëherë dhe në vijimësi.</i>

Titulli i gjetjes:	Mos ngritje e strukturës përkatëse për konsultimin publik.
Situata:	Nga auditimi konstatohet se FSHZH nuk ka caktuar një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik për bashkërendimin dhe administrimin e punës. Nuk ana e subjektit të audituar FSHZH, nuk u vendos në dispozicion asnjë provë dokumentare mbi publikimin e njoftimit të konsultimit publik, si dhe asnjë formë e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve. Gjithashtu, nuk dokumentohet se si janë njoftuar palët e interesit mbi arsyet dhe ndikimin që ka projekti, afati, vendi dhe mënyra se si mund të dërgohen rekomandimet, adresa e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.
Kriteri:	Neni 10 i ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, konkretisht: <i>óÇdo organ publik cakton një person si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik, të parashikuar nga ky ligj.ô</i> neni 11 “Mënyrat e njoftimit dhe marrja e komenteve dhe rekomandimeve” i ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, konkretisht:

	<i>“1. Njoftimi për projekt-aktet që do t’i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet nëpërmjet regjistrit elektronik. Në rastet kur organi publik e konsideron të nevojshme, njoftimi mund të kryhet edhe në një apo disa nga format e mëposhtme:</i> <i>a) me postë elektronike;</i> <i>b) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues;</i> <i>c) me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;</i> <i>ç) me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetat më të lexuara në nivel kombëtar.</i> <i>2. Marrja e komenteve dhe rekomandimeve në procesin e konsultimit publik kryhet në një nga format e përmendura më sipër, si dhe në raste të caktuara në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike.”</i> neni 13 të ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 <i>“Për njoftimin dhe konsultimin publik”</i> ku përcaktohet se: <i>“1. Në njoftimin për fillimin e procesit të konsultimit publik duhet të përcaktohen të paktën:</i> <i>a) arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projekt-aktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë;</i> <i>b) afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre;</i> <i>c) adresa e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të organit publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projekt-aktin;</i> <i>ç) vendi dhe data e organizimit të takimit publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij.</i> <i>2. Aksesit në dokumentacionin e nevojshëm që lidhet me projekt-aktin sigurohet edhe sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit.”</i>
Ndikimi:	Mos adresim i problematikave të qytetarëve.
Shkaku	Struktura jo ekzistente dhe mos zhvillim procedure korrekte e dëgjësës publike.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	FSHZH në bashkëpunim me institucionet përfituese të projekteve të marrin masa që të ngrenë strukturat përkatëse për zhvillimin e konsultimeve publike duke mirë informuar palët e interesit dhe duke reflektuar dhe zgjidhur problematikat e komunitetit.
Afati	<i>Menjëherë dhe në vijimësi.</i>

Për FSHZH:

Bazuar në përgjigjet e FSHZH me shkresën nr. 152/4, datë 03.12.2021 (ku pretendohet se nga e këtij institucioni janë kryer disa dëgjesa publike) si dhe objektit të ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 *“Për njoftimin dhe konsultimin publik”*, grupi i auditimit, gjatë fazës së auditimit në terren ka kërkuar dokumentacionin përkatës provues të këtyre dëgjësave.

Me e-mailin e datës 12.04.2022 drejtuar z. D. M. A. nga grupi i auditimit, është paraqitur një kërkesë e detajuar për dokumentacion, në zbatim të Ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 *“Për njoftimin dhe konsultimin publik”*, konkretisht u kërkuar:

“- Sa dëgjesa dhe konsultime publike janë kryer për projektin?”

- A janë kryer publikimet në Regjistrin elektronik të projekt-aktit, të njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin?

- A janë kryer publikimet në programin e transparencës, të planit vjetor të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes?

- Në çdo rast kërkohet informacion mbi procesin e njoftimit të konsultimit publik në të gjitha fazat duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.

- Në çdo rast cilat janë procesverbalet e mbajtura?

- Cili është caktuar Koordinatori për dëgjuesin publik?

- Ku janë bërë njoftimet për dëgjuesat publike, dokumentimi në çdo rast?

- Procesverbalet e mbajtura, si dhe në çdo rast rekomandimet në rrugë shkresore në se ka.

- Kopje të njoftimeve publike.

- Raportet për transparencën në procesin vendimmarrës 2019-2021

- Sa ankesa ka pasur për projektin, lista e tyre dhe një kopje.”

Nga ana e FSHZH u vendosën në dispozicion, në lidhje me kërkesën e mësipërme, vetëm disa foto për takime të zhvilluara në Bashkinë Vlorë të marra nga rrjetet sociale, në datat:

- 18 korrik 2020 “Prezantim i projektit Rikonstruksion i Rrugës Uji i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy By – Pass - eve”, me prezencë të Kryetarit të Dhomës së Tregtisë, Anëtarëve të Këshillit Bashkiak, FSHZH, përfaqësues të biznesit (në një kohë kur procedura e prokurimit të zbatimit ka nisur në shkurt 2020);

- 19.10.2018 óPrezantim i projektit ë ô me pjesëmarrës Bashkia Vlorë, Qarku Vlorë, UK Vlorë, etj. (pra nuk është dëgjues publik por prezantim i tij)

Si dhe në korrespondenca shkresore të kthimit të përgjigjeve:

- FSHZH përgjatë periudhës 2019-2021 janë zhvilluar konsultime me publikun për informacion lidhur me këtë ndërhyrje. (bashkëlidhur dokumenti)

Nga auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur kthimit të përgjigjes rezulton një listë me pjesëmarrës për takimin e zhvilluar në Bashkinë Vlorë datë 16.07.2020 me 14 pjesëmarrës dhe takimi është institucional pasi ka vetë pjesëmarrës nga institucionet Bashkia Vlorë dhe FSHZH dhe vetëm 2 pjesëmarrës nga fusha e biznesit. Nga FSHZH në lidhje me dëgjuesat publike konstatohet se nuk janë kryer publikimet në regjistrin elektronik për konsultimet si dhe publikimi në programin e transparencës. Nuk ka një bazë të dhënash mbi procesin e konsultimit publik. Pas kërkesave të kryera nga audituesit e KLSH nuk u vendos në dispozicion një informacion i qartë dhe i detajuar mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 *“Për njoftimin dhe konsultimin publik”*, konkretisht:

óOrganet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë:

a) publikimin në regjistrin elektronik të projekt-aktit, të njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projekt-akteve;

b) publikimin në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, në kuptim të këtij ligji;

c) dhënien e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar

Për takimet e zhvilluara, që gjithsesi nuk mund të klasifikohen si dëgjesa publike, nuk ka procesverbale për dokumentimin e diskutimeve dhe pretendimeve të ngritura nga palët, kjo në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, konkretisht:

“Organi publik, pas publikimit të njoftimit në regjistrin elektronik, mund të organizojë konsultime të drejtpërdrejta dhe takime publike me palët e interesuara. Konsultimet e drejtpërdrejta dhe takimet publike me palët e interesuara dokumentohen me procesverbal. Procesverbali i takimeve publike, të organizuara sipas këtij ligji, është dokument zyrtar. Për konsultime veçanërisht të rëndësishme, si dhe kurdo që është e mundur, me vendim të organit publik, takimet publike transmetohen në median audiovizive publike për të mundësuar ndjekjen e tyre nga publiku i gjerë.”

Nga FSHZH nuk është caktuar një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik për bashkërendimin dhe administrimin e punës, kjo në kundërshtim me nenin 10 të ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, konkretisht:

“Çdo organ publik cakton një person si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik, të parashikuar nga ky ligj.”

Nga FSHZH nuk u vu në dispozicion asnjë provë dokumentare mbi publikimin e njoftimit të konsultimit publik, marrjen e komenteve dhe rekomandimeve në asnjë formë, kjo në kundërshtim me nenin 11 “Mënyrat e njoftimit dhe marrja e komenteve dhe rekomandimeve” të ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, konkretisht:

“1. Njoftimi për projekt-aktet që do t'i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet nëpërmjet regjistrit elektronik. Në rastet kur organi publik e konsideron të nevojshme, njoftimi mund të kryhet edhe në një apo disa nga format e mëposhtme:

a) me postë elektronike;

b) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik iniciues;

c) me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;

ç) me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar.

2. Marrja e komenteve dhe rekomandimeve në procesin e konsultimit publik kryhet në një nga format e përmendura më sipër, si dhe në raste të caktuara në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike.”

Nuk dokumentohet si janë njoftuar palët e interesit mbi arsyet dhe ndikimin që ka projekti, afati, vendi dhe mënyra se si mund të dërgohen rekomandimet, adresa e kontaktit të koordinitorit për njoftimin dhe konsultimin publik, kjo në kundërshtim me nenin 13 të ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” ku përcaktohet se:

“1. Në njoftimin për fillimin e procesit të konsultimit publik duhet të përcaktohen të paktën:

- a) arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projekt-aktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë;
 - b) afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre;
 - c) adresa e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të organit publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projekt-aktin;
 - ç) vendi dhe data e organizimit të takimit publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij.
2. Aksesit në dokumentacionin e nevojshëm që lidhet me projekt-aktin sigurohet edhe sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit.”

Nga ana e FSHZH u vendosën në dispozicion ankesat e ardhura nga qytetarët për këtë projekt, konkretisht:

Me shkresën nr. 668/7, datë 11.11.2021 “Kërkesë për verifikim e pronës në raport me projektin Rikonstruksion i Rrugës Uji i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i 2 By-Pass” e zotit A. B..

FSHZH ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 668/8, datë 16.11.2021 óKthim përgjigjeó, konkretisht:

óReferuar kërkesës suaj, fillimisht sqarojmë se nuk përkojnë të dhënat e pasurisë në kërkesën në raport me hartën e dërguar bashkëlidhur.

Referuar informacionit të gjeneruar nga Departamenti i Inxhinierisë, në FSHZH harta juaj përkon me parcelën nr. 384/I, e cila e pozicionuar në fillim të Bypassit të parë dhe rruga parashikohet të impaktojë një pjesë të sipërfaqes suaj.

Sërish në këtë rast sqarojmë se për pronarët e pasurive të paluajtshme, prona e të cilëve mund të cenohet nga zhvillimi i projekteve, nga ana e Bashkisë Vlorë dhe Agjencive përkatëse shtetërore do të ndiqen procedurat ligjore për kompensimin e plotë të tyre në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tijó

Me shkresën nr. 152/4, datë 03.12.2021 “Kthim Përgjigje”, FSHZH ka kthyer përgjigje kërkesës së ardhur dhe protokolluar me nr. 152/3 datë 26.11.2021. Në këtë përgjigje FSHZH thekson:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit si agjenci zbatuese, në të gjitha projektet e realizuara, nënshkruan marrëveshja investimi me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore si përfutuese të investimit dhe njëkohësisht si përfaqësuese e grupeve të interesit brenda territorit të tyre, ku NJVV marrin përsipër lejet dhe miratimet e ndryshme, përgatitjen e dosjes për shpronësimet trajtimin dhe trajtimin e zgjidhjen e problemeve juridike ose sociale, në raport me banorët.

Projekti gjithashtu bazohet në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, Strategjia Territoriale dhe është gjetur zgjidhja jo vetëm më e favorshme teknike, por edhe për të minimizuar impaktin mjedisor dhe social duke qenë në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet më të mira.

Pretendimi i ngritur në kërkesën tuaj nuk qëndron pasi nga ana e FSHZH përgjatë periudhës 2019-2021 janë zhvilluar konsultime me publikun për informacion lidhur me këtë ndërhyrje. (bashkëlidhur dokumenti)

Nga auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur kthimit të përgjigjes rezulton një listë me pjesëmarrës për takimin e zhvilluar në Bashkinë Vlorë datë 16.07.2020 me 14 pjesëmarrës dhe takimi është institucional pasi ka vetëm pjesëmarrës nga institucionet Bashkia Vlorë dhe FSHZH dhe vetëm 2 pjesëmarrës nga fusha e biznesit. Përveç kësaj, ashtu siç edhe u përmend edhe më

sipër, këto takime nuk kanë qenë në lidhje me marrjen e mendimeve nga personat e prekur nga realizimi i projektit, kjo për vet faktin se projekti i hartuar nga ana e projektuesit është prokuruar në fillim të vitit 2020.

Me shkresën datë 03.12.2021 *“Kërkesë për trajtim dhe marrjen e masave të menjëhershme parandaluese”* drejtuar Këshillit të Ministrave, Kryeministrit, Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Zv. Kryeministrit, Avokatit të Popullit, si dhe për dijeni Kryetarit të Bashkisë Vlorë dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit të Kryeplakut të Fshatit Rradhimë z. H. H., është shprehur se:

“Projekti cenon drejtpërdrejtë jetën e banorëve të Rradhimës. Ky projekt cenon banesat, bizneset si dhe pasuri të tjera të paluajtshme të banorëve të fshatit Rradhimë por edhe Orikum e Dukat.

Banorët e zonës që preken nga Bypassi i Parë, qysh në vitin 2020 i janë drejtuar me kërkesa të njëpasnjëshme Kryetarit të Bashkisë Vlorë, Këshillit Bashkiak Vlorë si dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, për shkak se nga ana e institucioneve kompetente nuk janë zhvilluar takime dhe konsultime publike me banorët e zonës për sa i përket zbatimit të këtij projektit.

Në muajin mars të vitit 2021, pas kërkesë – ankesave të përsëritura dhe të nënshkruara nga gjithë banorët që preken nga zbatimi i projektit, është zhvilluar një takim jo formal në terren”

Me shkresë nr. 3818/1, datë 28.12.2021 *“Përcillet letra e zotit H. H., Kryeplak i fshatit Rradhimë”* Sekretari i Përgjithshëm i Presidentit të Republikës ka përcjellë ankesën Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Bashkisë Vlorë, në vëmendje të Avokatit të Popullit dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Me shkresën nr. 363.2, datë 30.12.2021 *“Kthim përgjigje”* FSHZH i ka thyer përgjigje Sekretarit të Përgjithshëm të Presidencës duke përcjellë të gjithë praktikën.

Me shkresën nr. 6599/1, datë 14.01.2022 *“Dërgohet për ndjekje dhe kompetence letra e z. H. H., kryeplak i fshatit Rradhimë”* Sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrit ka përcjellë ankesën tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Shtetërore të Shpronësimeve, Bashkinë Vlorë, Drejtorinë Vendore të ASHK Vlorë, për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm të Presidencës, ASHK, FSHZH, Ankimuesit.

Me shkresën nr. 96/1, datë 28.01.2022 *“Kthim Përgjigje”* Agjencia Shtetërore e Shpronësimeve (ASHSH) ka kthyer përgjigje Sekretarit të Përgjithshëm të Presidencës dhe për dijeni Kryeministrit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkisë Vlorë, Drejtorisë Vendore të ASHK Vlorë, ASHK, Bashkisë Vlorë, FSHZH dhe ankimuesit ku sqaron mbi procedurën që ndiqet për shpronësim si dhe mbi faktin se deri në datë 28.01.2022 nuk është depozituar asnjë praktikë shpronësimi në lidhje me këtë projekt.

Me shkresën nr. 428/1, datë 02.02.2022 *“Kthim përgjigje”* të Drejtorisë Vendore të ASHK Vlorë drejtuar Kryeministrit, për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm të Presidencës, ASHK, FSHZH, ankimuesit, ku shprehet se në këtë institucion nuk ka shkuar asnjë projekt i miratuar si dhe kërkesë për kalim pronësie.

Me ankesën nr. 756 prot., datë 08.02.2021 drejtuar FSHZH, një grup banorësh të zonës që preken nga zbatimi i projektit, shprehen:

1. Mbi gjurmën e projektit pasi prek rreth 3000 metër katror tokë private e cila mund të evitohet duke vazhduar mbi gjurmën ekzistuese të zonës;

2. Ndërtimi i një mbikalimi i cili do të cenojë pronat që ndodhen mbi rrugë.

Me shkresën nr. 756/1, datë 26.02.2021 *“Kthim përgjigje”* FSHZH s'ka adresuar problematikën Bashkisë Vlorë.

Me shkresën nr. 4005/1 prot., datë 11.03.2021 *“Kërkesë për ndryshim të projektit të zbatimit për projektin e “Hartimi i projekt – zbatimit dhe preventivit për rehabilitimin e rrugës Uji i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy By – Pass - eve”*”, Bashkia Vlorë ka kërkuar rishikim të projektit në bazë të ankesave.

Me shkresën nr. 1056/2, datë 24.03.2021 *“Kthim përgjigje”* FSHZH sqaron se është kompetence e Bashkisë trajtimi i problemeve sociale.

Me shkresën nr. 1933 prot., datë 26.05.2021 *“Kërkesë për rishqyrtim projekti”* drejtuar FSHZH nga ana e z. V. D. është kërkuar spostimi i gjurmës së rrugës.

Me shkresën nr. 1933/1, datë 01.06.2021 *“Kthim përgjigje”* FSHZH ka adresuar problematikën në Bashkinë Vlorë.

Për Bashkinë Vlorë:

Grupi i auditimit me e-mailin e datës 19.04.2022 i ka bërë kërkesë zyrtare me e-mail për vendosjen në dispozicion të dokumentacionit, duke përcjellë edhe programin e auditimit Bashkisë Vlorë, konkretisht:

óNë zbatim të Ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 *“Për njoftimin dhe konsultimin publik”*:

“- Sa dëgjesa dhe konsultime publike janë kryer për projektin

- A janë kryer publikimet në Regjistrin elektronik të projekt-aktit, të njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin.

- A janë kryer publikimet në programin e transparencës, të planit vjetor të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes.

- Në çdo rast kërkohet informacion mbi procesin e njoftimit të konsultimit publik në të gjitha fazat duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e dri te miratimi i aktit përfundimtar.

- Në çdo rast procesverbalet e mbajtura.

- Koordinatori për dëgjesën publike

- Ku janë bërë njoftimet për dëgjesat publike, dokumentimi në çdo rast

- Procesverbalet e mbartura, si dhe në çdo rast rekomandimet në rrugë shkresore në se ka

- Kopje të njoftimeve publike

- Raportet për transparencën në procesin vendimmarrës 2019-2021

- Sa ankesa ka pasur për projektin, lista e tyre dhe një kopje.

- Evidentimi nga projekti i subjekteve dhe kostove të zbatimit për subjektet që preken nga projekti

- Evidentimi i kostove financiare të shpronësimeve dhe procedura e ndjekur deri te VKM

- Përputhshmëria e projektit me Vendimet e KKT (Vendimi i KKT nr. 1, datë 08.10.2013, Vendimi i KKT nr. 5, datë 29.12.2014, Vendimi i KKT nr. 1, datë 16.10.2017 i ndryshuar me Vendimin e KKT nr. 4 datë 17.05.2019 dhe Vendimin e KKT nr. 3, datë 03.12.2020)

- Masat e marra nga Bashkia për garantimin e truallit

- Evidentimi i gjithë problemeve sociale dhe juridike dhe zgjidhja e tyre

- Leja e ndërtimit për projektin, pagesa e tarifave përkatëse.

- Respektimi i Kushteve mjedisore dhe VNM për këtë rrugë.

- Leja mjedisore dhe mbulimi i tarifës përkatëse.

- A është dorëzuar sheshi i projektit?”

Në datën 27.04.2022 me e-mail nga Bashkia Vlorë u vendosën në dispozicion dokumentacionin që ata dispononin nga ku u konstatua se nga ky institucion nuk administrohet asnjë provë

dokumentare mbi zhvillimin e dëgjësive publike në kundërshtim me Ligjin nr. 146/2014, datë 30.10.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Sa më sipër është në kundërshtim me:

Neni 5

Parimet në procesin e njoftimit e të konsultimit publik

Procesi i njoftimit dhe i konsultimit publik kryhet në bazë të parimeve të mëposhtme:

- a) transparenca gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese;*
- b) efektshmëria e procesit të vendimmarrjes në organet publike;*
- c) përgjegjësia e organeve publike ndaj palëve të interesuara.*

Neni 6

Detyrimi për njoftimin dhe konsultimin publik

1. Organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë:

- a) publikimin në regjistrin elektronik të projekt-aktit, të njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projekt-akteve;*
 - b) publikimin në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, në kuptim të këtij ligji;*
 - c) dhënien e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.*
- 2. Organi publik, pas publikimit të njoftimit në regjistrin elektronik, mund të organizojë konsultime të drejtpërdrejta dhe takime publike me palët e interesuara. Konsultimet e drejtpërdrejta dhe takimet publike me palët e interesuara dokumentohen me procesverbal. Procesverbali i takimeve publike, të organizuara sipas këtij ligji, është dokument zyrtar. Për konsultime veçanërisht të rëndësishme, si dhe kurdo që është e mundur, me vendim të organit publik, takimet publike transmetohen në median audiovizive publike për të mundësuar ndjekjen e tyre nga publiku i gjerë.*
- 3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, organet publike nuk përjashtohen nga detyrimi për publikimin dhe konsultimin e projekt-akteve, sipas ligjeve të veçanta për funksionimin e tyre.*

Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se nga ana e përfaqësuesve të FSHZH dhe Bashkisë Vlorë nuk janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e Ligjit nr. 44/2020 datë 23.04.2020 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri”, neni III Ekzekutimi i Projektit, seksioni 3.01 *Angazhime të tjera afirmuese të Projektit*, ku përcaktohet se:

Krahas angazhimeve të përgjithshme të parashtruara në Nenin IV të Termave dhe Kushteve Standarde, Huamarrësi, përveç kur Banka bie dakord ndryshe:

- c) Siguron që Enti Zbatues të përmbushë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;*
- d) Ofron ose siguron ofrimin e të gjitha licencave, miratimeve apo pëlqimeve qeveritare që duhen siguruar për financimin dhe realizimin e projektit dhe aktiviteteve të tij, duke përfshirë, pa*

asnjë kufizim, të gjitha lejet dhe licencat e nevojshme për të garantuar të drejtën e kalimit dhe të drejtat e tjera të përdorimit të tokës për zbatimin e Projektit;

Seksioni 3.04 *Angazhime për Përputhshmërinë Mjedisore dhe Sociale* kupërcaktohet se:

b) .. Huamarrësi zbaton dhe respekton me kujdes drejtpërdrejt përmes Entit Zbatues apo mënyrave të tjera (si të çmohet e përshtatshme) Planin e Veprimit Mjedisor dhe Sociale dhe monitoron zbatimin e këtij plani në përputhje me dispozitat që parashtrohen në atë plan;

Gjithashtu, nga palët si më sipër nuk janë marrë masat e duhura për respektimin e marrëveshjes së lidhur sipas aktit të administruar në FSHZH me nr. 702/1 prot., datë 30.04.2020 *'Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet FSHZH dhe Bashkisë Vlorë për objektin Për rikonstruksionin e rrugës Uji i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimin e 2 By Pass – eve'*, neni 3, neni 4 dhe neni 5.

(Nga grupi i auditimit në Aktkonstatim është lenë detyrë që FSHZH ti përcjelli konstatimet në Bashkinë Vlorë për njohje për të paraqitur çdo dokumentacion shkresor ose elektronik që i shërben procesit të auditimit në lidhje me procedurat e shpronësimit si dhe atyre të konsultimeve publike të ndjekura)

2.2 Mbi përputhshmërinë e projektit me vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit 'Për zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike dhe brezi bregdetar' nr. 1, datë 08.10.2013 dhe Vendimin nr. 5, datë 29.12.2014 'Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit Urban' dhe Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Vlorë miratuar me Vendimin e KKT, nr. 1, datë 16.10.2017 'Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë', i rishikuar me Vendimin nr. 4 datë 17.05.2019 dhe nr. 3, datë 03.12.2020 'Për miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë'

Në zbatim të pikës 2 të Programit të Auditimit nr. 265/2 prot, datë 11.03.2022, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit 'Për zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike dhe brezi bregdetar' nr. 1, datë 08.10.2013;
- Vendimi nr. 5, datë 29.12.2014 *'Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit Urban'*;
- Plani i Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Vlorë miratuar me Vendimin e KKT, nr. 1, datë 16.10.2017 *'Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë'*, i rishikuar me Vendimin nr. 4 datë 17.05.2019 dhe nr. 3, datë 03.12.2020 *'Për miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë'*;
- Korrespondenca të ndryshme;

Titulli i gjetjes:	Vonesa në nxjerrjen e lejes së ndërtimit.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për zbatimin e punimeve civile në këtë segment është lidhur kontrata e punimeve me referencë DTM50123/e /2020/1 datë 07.12.2020 me OE óA.-M.ô me vlerë 8,674,246.62 USD me TVSH me afat 12 muaj ndërsa për mbikëqyrjen e punimeve është lidhur kontrata me BOE óP.&E.ô sipas kontratës me referencë

	DTM50123/e /2020/4 datë 28.12.2020 me vlerë 986,160 USD me TVSH. Aktualisht, pas ndryshimit të projektit fillestar të dorëzuar nga ana e projektuesit BOE I.& A. 4 & S. C., projekti i ri nuk disponon akoma leje ndërtimi, nuk është dorëzuar sheshi i ndërtimit, punimet në terren nuk kanë filluar dhe janë ende në proces procedurat për shpronësimet. Në lidhje me ndryshimet e projektit nga ana e subjektit të audituar u vu në dispozicion dokumentacioni si më poshtë: - Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 9879 prot., datë 15.11.2018 dhe në FSHZH me nr. 1518 prot., 20.11.2018, Bashkia Vlorë i është drejtuar FSHZH dhe projektuesit me një shkresë ku i ka përcjellë projektin propozimet në lidhje me ndërtimin e dy Bypass në rrugën Radhimë në Orikum. Sipas këtij projekt propozimi është rishikuar gjurma e propozimit fillestar duke marrë parasysh parcelat ekzistuese, gjurmët e rrugëve ekzistuese, njësitë strukturore referuar PPV si dhe relacioneve shpjeguese. Sipas kësaj shkresë është cituar fakti se Bashkia Vlorë e ka bërë këtë projekt propozim në bashkëpunim me grupet e interesit, bizneset që operojnë në atë zonë, si palë të interesuara; - Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 6131 prot., datë 22.07.2020 dhe në FSHZH me nr. 1635 prot., 24.07.2020 Bashkia Vlorë i ka kërkuar FSHZH rishikimin e projektit me qëllim reflektimin e projekt-propozimeve të bëra nga kjo NJV e cila sipas Bashkisë është kryer në bashkëpunim me grupet e interesit, bizneset që operojnë në atë zonë, si palë të interesuara; - Me shkresën e administruar në FSHZH me nr. 2171 prot., datë 22.09.2020 i është bërë me dije Bashkisë Vlorë fakti mbi vonesat në drejtim të Planit të Veprimtimit të Risistemimit për rrugën Uji i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy Bypass në rrugë. Edhe pas një takimi të kryer në datë 16.07.2020 të kryer në Bashkinë Vlorë me përfaqësues të Bashkisë dhe komunitetit nuk ka asnjë rezultat mbi marrjen e titujve të pronësisë nga ASHK për këtë arsye është kërkuar një angazhim shtesë nga ana e Njesisë Vendore; - Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 602/1 prot., datë 19.01.2021 dhe në FSHZH me nr. 342 prot., 22.01.2021, Bashkia Vlorë i ka kërkuar FSHZH rishikimin e projektit me qëllim reflektimin e projekt-propozimeve të bëra nga kjo NJV e cila sipas Bashkisë është kryer në bashkëpunim me grupet e interesit, bizneset që operojnë në atë zonë, si palë të interesuara duke kërkuar spostimin e gjurmës së Bypass në rrugë si dhe spostimin e rrethrotullimit i cili sipas Bashkisë Vlorë është jo funksional. Kësaj shkresë i është bashkëlidhur edhe ankesa e bërë nga ana e nga një banori, prona e të cilit preket nga kalimi i gjurmës së projektit. - Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 1899/1 prot., datë 19.02.2021 dhe në FSHZH me nr. 342/1 prot., 01.03.2021, Bashkia Vlorë i ka kërkuar FSHZH rishikimin e projektit me qëllim reflektimin e projekt-propozimeve të bëra nga kjo NJV e cila sipas Bashkisë është kryer në bashkëpunim me grupet e interesit si dhe pronarëve legjitimë në atë zonë duke kërkuar spostimin e gjurmës së projektit pasi ajo e miratuar aktualisht në momentin e shkresës ka qenë e tillë që sipas Bashkisë ndan në mes parcelat
--	--

	dhe sjell një kosto të madhe edhe për shpronësimin e tyre. Gjithashtu është përmendur fakti se rreth-rrotullimi i parashikuar është jo funksional dhe nuk zgjidh trafikun e mjeteve. Kësaj shkresë i është bashkëlidhur edhe ankesa e bërë nga ana e një grupi banorësh të Radhimës, prona e të cilëve preket nga kalimi i gjurmës së projektit; - Me shkresën e administruar në FSHZH me nr. 342/2 prot., datë 04.03.2021 është dorëzuar projekti nga ana e Projektuesit sipas kërkesave të bëra nga ana e Bashkisë Vlorë. Sipas të gjithë dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe pretendimeve të subjektit të audituar rezulton se është aplikuar për leje ndërtimi por kjo leje nuk është miratuar akoma për shkak të problemeve me pronat dhe aktualisht disponohet vetëm një Draft i miratimit të lejes. <i>(Shiko Aneksin nr. 2.1).</i>
Kriteri:	Ligji nr. 44/2020 datë 23.04.2020 <i>“Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri”</i> , neni III Ekzekutimi i Projektit.
Ndikimi:	Vonesa në realizimin e projektit sipas marrëveshjes së financimit të ratifikuar me ligj.
Shkaku	Mungesa e ndjekjes në mënyrën e duhur të hapave për realizimin e projektit nga ana e FSHZH, konkretisht të atyre në drejtim të bashkëpunimit me Bashkinë Vlorë për identifikimin e saktë dhe në kohë të gjurmës së projektit.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga ana e FSHZH, në zbatim të Nenit III Ligji nr. 44/2020 datë 23.04.2020 dhe në cilësinë e <i>Entit Zbatues të Projektit</i> të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme kryesisht ato në drejtim të bashkëpunimit me Bashkinë Vlorë, sipas Marrëveshjes së lidhur me këtë qëllim mes FSHZH dhe Bashkisë Vlorë në datë 30.04.2020 me qëllim përshpejtimin e proceduarve të nxjerrjes së lejes së ndërtimit.
Afafti	<i>Menjëherë dhe në vijimësi.</i>

Projekti *“Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale”* është një Projekt i cili ka parashikuar ndërhyrje në rrjetin rrugor rajonal në zona me potencial bujqësor dhe turistik në të gjithë vendin dhe financohet nga Banka Botërore dhe BERZH me vlerë 100 milionë USD. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se kuadri ligjor kryesor mbi të cilin është realizuar ky Projekt është ligji nr. 54/2018 datë 23.07.2018 *“Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale”* dhe ligji nr. 44/2020 datë 23.04.2020 *“Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri”*. Projekti objekt auditimi *Rikonstruksioni i rrugës së Uji i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy Bypas – ve* është pjesë e listës së investimeve të cilat i janë shtuar projektit *Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale* në fazën e dytë të këtij projekti në kuadër të Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim datë 10.02.2020. Financimi është parashikuar të kryhet nga Transhi 1. Kjo rrugë është parashikuar ti shërbejë jo vetëm banorëve të zonës midis Ujit të Ftohtë deri në Orikum, por edhe të gjithë turistëve vendas dhe të huaj të cilët frekuentojnë zonën bregdetare

jugore të Shqipërisë. Projekti fillon në dalje të Tunelit tek Uji i Ftohtë, Vlorë dhe përfundon tek Marina në Orikum, me një gjatësi totale prej 10.75 km. Projekti parashikon ndërhyrje rikonstruksioni për rrugën ekzistuese nacionale Vlorë-Orikum dhe ndërtimin e dy by-pass-eve përpara dhe pas fshatit Radhimë. Për zbatimin e punimeve civile në këtë segment është lidhur kontrata e punimeve civile me referencë DTM50123/W/2020/1 datë 07.12.2020 me OE óA.-M.ô me vlerë 8,674,246.62 USD me TVSH me afat 12 muaj ndërsa për mbikëqyrjen e punimeve është lidhur kontrata me BOE óP.&E.ô sipas kontratës me referencë DTM50123/W/2020/4 datë 28.12.2020 me vlerë 986,160 USD me TVSH.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se aktualisht, pas ndryshimit të projektit fillestar të dorëzuar nga ana e projektuesit BOE I.& A.& S. C., projekti i ri nuk disponon akoma leje ndërtimi, nuk është dorëzuar sheshi i ndërtimit, punimet në terren nuk kanë filluar dhe janë ende në proces procedurat për shpronësimet.

Në lidhje me ndryshimet e projektit nga ana e subjektit të audituar u vu në dispozicion dokumentacioni si më poshtë:

- Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 9879 prot., datë 15.11.2018 dhe në FSHZH me nr. 1518 prot., 20.11.2018, Bashkia Vlorë i është drejtuar FSHZH dhe projektuesit me një shkresë u i ka përcjellë projektin propozimet në lidhje me ndërtimin e dy Bypass në ve në rrugën Radhimë në Orikum. Sipas këtij projekt-propozimit është rishikuar gjurma e propozimit fillestar duke marrë parasysh parcelat ekzistuese, gjurmët e rrugëve ekzistuese, njësitë strukturore referuar PPV si dhe relacioneve shpjeguese. Sipas kësaj shkresë është cituar fakti se Bashkia Vlorë e ka bërë këtë projekt propozim në bashkëpunim me grupet e interesit, bizneset që operojnë në atë zonë, si palë të interesuara;

- Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 6131 prot., datë 22.07.2020 dhe në FSHZH me nr. 1635 prot., 24.07.2020 Bashkia Vlorë i ka kërkuar FSHZH rishikimin e projektit me qëllim reflektimin e projekt-propozimeve të bëra nga kjo NJV e cila sipas Bashkisë është kryer në bashkëpunim me grupet e interesit, bizneset që operojnë në atë zonë, si palë të interesuara;

- Me shkresën e administruar në FSHZH me nr. 2171 prot., datë 22.09.2020 i është bërë me dije Bashkisë Vlorë fakti mbi vonesat në drejtim të Planit të Veprimit të Risistemimit për rrugën Uji i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy Bypass në ve. Edhe pas një takimi të kryer në datë 16.07.2020 të kryer në Bashkinë Vlorë me përfaqësues të Bashkisë dhe komunitetit nuk ka asnjë rezultat mbi marrjen e titujve të pronësisë nga ASHK për këtë arsye është kërkuar një angazhim shtesë nga ana e Njesisë Vendore;

- Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 602/1 prot., datë 19.01.2021 dhe në FSHZH me nr. 342 prot., 22.01.2021, Bashkia Vlorë i ka kërkuar FSHZH rishikimin e projektit me qëllim reflektimin e projekt-propozimeve të bëra nga kjo NJV e cila sipas Bashkisë është kryer në bashkëpunim me grupet e interesit, bizneset që operojnë në atë zonë, si palë të interesuara duke kërkuar spostimin e gjurmës së Bypass në it si dhe spostimin e rreth-rrotullimit i cili sipas Bashkisë Vlorë është jo funksional. Kësaj shkresë i është bashkëlidhur edhe ankesa e bërë nga ana e nga një banori, prona e të cilit preket nga kalimi i gjurmës së projektit.

- Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 1899/1 prot., datë 19.02.2021 dhe në FSHZH me nr. 342/1 prot., 01.03.2021, Bashkia Vlorë i ka kërkuar FSHZH rishikimin e projektit me qëllim reflektimin e projekt-propozimeve të bëra nga kjo NJV e cila sipas Bashkisë është kryer në bashkëpunim me grupet e interesit si dhe pronarëve legjitimë në atë zonë duke kërkuar spostimin e gjurmës së projektit pasi ajo e miratuar aktualisht në momentin e shkresës ka qenë e

tillë që sipas Bashkisë ndan në mes parcelat dhe sjell një kosto të madhe edhe për shpronësimin e tyre. Gjithashtu është përmendur fakti se rreth-rrotullimi i parashikuar është jo funksional dhe nuk zgjidh trafikun e mjeteve. Kësaj shkrese i është bashkëlidhur edhe ankesa e bërë nga ana e një grupi banorësh të Radhimës, prona e të cilëve preket nga kalimi i gjurmës së projektit;

- Me shkresën e administruar në FSHZH me nr. 342/2 prot., datë 04.03.2021 është dorëzuar projekti nga ana e Projektuesit sipas kërkesave të bëra nga ana e Bashkisë Vlorë.

Nga sa më sipër si dhe pretendimeve të subjektit të audituar rezulton se është aplikuar për leje ndërtimi por kjo leje nuk është miratuar akoma për shkak të problemeve me pronat dhe aktualisht disponohet vetëm një Draft i miratimit. (Aneksi nr. 1 óDraft Projekt Vendimi mbi miratimin e lejes së ndërtimit të infrastrukturës: óRehabilitimi i Rrugës Uji i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy By në Passeveô ô)

2.3 Mbi evidentimin nga projekti të subjekteve dhe kostove të zbatimit për subjektet pasuritë e të cilëve preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy By – Pass – eve”. Evidentimi i kostove financiare të shpronësimeve për interes publik në zbatim të ligjit nr. 861, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë prone private për interes publik”

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit nr. 265/2, datë 15.03.2022, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Korrespondenca shkrese me Drejtorinë Vendore të ASHK Vlorë;
- Plani për marrjen e tokës;
- Kontrata e shërbimit me referencë sh/shërbime/2018/goa/sh-1 e lidhur midis FSHZH dhe BOE óI.ô ShPK (35%), óA.ô ShPK (35%) dhe óS. C.ô ShPK (30%), datë 12.01.2018;
- Metodologjia e vlerësimit të pasurive të paluajtshme;
- Etj.

Nga auditimi u konstatua se:

Për realizimin e projektit óRikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy By në Passneveô është lidhur kontrata e shërbimit me referencë sh/shërbime/2018/goa/sh-1 e lidhur midis FSHZH dhe BOE óI.ô ShPK (35 %), óA.ô ShPK (35 %) dhe óS. C.ô ShPK (30 %), datë 12.01.2018. Referuar Pikës 3.6 *Qëllimi dhe objektivat e termave të Referencës përcaktohet se:*

‘Konsulenti do të ofrojë informacionin, raport – vlerësimet dhe dokumentet që janë të nevojshme që financierët e jashtëm të kryejnë vlerësimin e punimeve të tyre përkatëse, duke përfshirë projektimet e tyre inxhinierike paraprake dhe përfundimtare, dokumentet e tenderit dhe raportet e ndikimit në mjedis dhe social...’

Konsulenti gjithashtu pritet të ofrojë planet për shpronësimin e tokës dhe një raport për vlerësimin e pasurive në çdo nënprojekt, kur ndodhin risistemime të padëshiruara.’

Titulli i gjetjes:	Ecuri e ngadaltë me procesin e shpronësimeve.
Situata:	Deri në fund të periudhës objekt auditimi (datë 29.04.2022) nuk ka një projekt përfundimtar të pranuar dhe miratuar nga FSHZH (zhvillues i projektit) dhe Bashkia Vlorë (përfitues) por ka një projekt që është në proces ndryshimi ku është evidentuar një gjurmë dhe një listë me prona që preken nga projekti. Në raportin e hartuar nga vlerësuesja e pasurive të paluajtshme zj. M. F. janë

	evidentuar pronat dhe vlera koresponduese për shpronësim. Implementimi i projektit óRikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy By ñ Pass ñ eveô prek pronat e Bashkisë Vlorë në zonat Kadastrale 8602 (Vlorë) dhe 3140 (Radhimë), Njësia Administrative Orikum. Për të minimizuar efektet e shpronësimit, ndërtimi i rrugës, që do të mundësohet nga zbatimi i projektit, ka bërë të mundur shmangien e pronave private të zëna nga ndërtesa banimi dhe/ose objekte biznesi aty ku ka qenë teknikisht e mundur. Kuadri ligjor në fuqi për zbatimin e projektit parashikon që personat e prekur nga projekti do të kompensohen për çdo humbje të aseteve fizike, të ardhurave dhe fitimeve që rrjedhin nga realizimi i këtij investimi, nëse këto humbje janë të përkohshme ose të përhershme. Megjithatë, dëshmitë e mbledhura nga vizitat në terren kanë treguar se ndërtimi i rrugëve prek kryesisht parcelat në pronësi publike, tokat bujqësore, vegjetacionin dhe prodhimin në këto toka. Zbatimi i projektit do të ndikojë drejtpërdrejt tek personat që preken nga projekti sepse do të shpronësohen për një sipërfaqe të caktuar të pronës së tyre. Shpronësimi kryhet për interes publik dhe toka bujqësore e marrë do të përdoret për ndërtimin dhe vënien në funksion të objektit “<i>Rikonstruksioni i rrugës ekzistuese Vlorë-Orikum dhe i dy By-pass-eve</i>”. Në sipërfaqen 47 311.14 m² janë marrë në konsideratë sipërfaqja 15 695.44 m² - By Pass 1 dhe 31 615.70 m² By Pass2. Nga vlerësimi i kryer deri në këtë pikë të projektit rezulton se në total nga ndërtimi i dy By-Pass ñ eve preken 50 prona, specifikisht 22 prona nga By ñ pass 1 dhe 28 prona nga By ñ pass 2. NëAneksin nr. 3.2 pasqyrohet “<i>Lista e pronave që preken nga projekti dhe që do të shpronësohen</i>”. <u>Kosto totale e shpronësimit është 567,733,680 lekë ku përveç vlerës së tokës futen edhe kosto e produkteve bujqësore, si dhe zhvlerësimi i pronës nga shpronësimi i një pjese të saj.</u>
Kriteri:	Ligji nr. 44/2020 datë 23.04.2020 “ <i>Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri</i> ”;
Ndikimi:	Mos fillimi i punimeve dhe i disbursimeve të projektit sjell rritje e kostos së huas.
Shkaku	Mos evidentim i plotë dhe përfundimtar të pronave të prekura, mos koordinimin midis institucioneve të përfshira.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	FSHZH në bashkëpunim me të gjithë institucionet e përfshira në procesin e shpronësimeve të marrin masa që të evidentohen lista e plotë e pronarëve, vlera përkatëse dhe të nisin menjëherë hapat ligjor për përfundimin e procesit të shpronësimeve dhe kompensimin e pronarëve.
Afati	<i>Menjëherë dhe në vijimësi.</i>

Mënyra e kompensimit të vlefshëm për këtë procedurë shpronësimi sipas legjislacionit shqiptar në fuqi është kompensimi financiar, në vlerë monetare. Kostoja totale për kompensimin e shpronësimeve (për By Pass 1 dhe By Pass 2) llogaritet paraprakisht **9,651,472.56lekë**, e

vlefshme për një sipërfaqe totale prej 47,311.14 m², sipas Vendimit të KM nr. 89, datë 03.02.2016 për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë.

Kostoja totale për kompensimin e shpronësimeve është vlerësuar paraprakisht **366,661,335 lekë**, e vlefshme për një sipërfaqe totale prej 47,311.14 m², sipas vlerës mesatare të tregut të Pasurive të Paluajtshme të përgatitur sipas raporteve të vlerësimit, ndërsa Kompensimi për strukturat e përkohshme (asetet) si gardhe, tenda, do të realizohet nga kompania zbatuese e projektit duke përfshirë edhe punimet e parandalimit civil, duke mundësuar të njëjtën strukturë ndërtimi të tyre e cila do të jetë në përputhje me atë të projektit.

Në bazë të Marrëveshjes së Huas datë 10.02.2020 ratifikuar me Ligjin nr. 44/2020, datë 23.4.2020 *“Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin ekonektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale në Shqipëri”*, shpronësimet duhet të kryhen me vlerë tregu.

Vlera e shpronësimeve është rivlerësuar bazuar në kërkesat e EBRD:

Politikat e BERZH kërkojnë zbatimin e legjislacionit shqiptar për vlerësimin dhe kompensimin e humbjeve për aq kohë sa nëpërmjet këtij zbatimi mundësohet respektimi i Plani i Sistemit Lokal të sanksionuar në dokumentet zyrtare. Në këtë proces, është thelbësore që kompensimi financiar të sigurojë zëvendësimin e aseteve të humbura. Kompensimi duhet të bëhet i plotë për asetet që preken drejtpërdrejt nga projekti. Kështu, dokumenti mbi Politikën Operacionale për Zhvendosje Vullnetare thotë shprehimisht:

Ç“Në lidhje me tokën dhe strukturat, ókostoja e zëvendësimitó përcaktohet si më poshtë: Për tokën bujqësore është vlera e tregut e tokës me të njëjtin kapacitet prodhimi ose përdorimi që ndodhet pranë tokës së prekur, përpara zbatimit të projektit ose përpara zhvendosjes (më e lartë mes tyre) plus kostot e përgatitjes së tokës për të sjellë në kushtet e tokës së prekur plus kostot e çdo regjistrimi apo takes. Për shtëpitë dhe strukturat e tjera, është vlera e tregut e materialeve të nevojshme për të ndërtuar strukturën e prekur ose për të rregulluar strukturat e prekura pjesërisht plus kostot e transportit të materialeve në kantier, plus kostot e punës dhe çdo taksë ose regjistrim. Në përcaktimin e kostove të zëvendësimit, amortizimi i aktiveve materiale nuk merret parasysh dhe as nuk zbritet vlera e përfitimit nga projekti nga vlera e aktivitetit.

ÇPolitikat Operacionale të BERZH-it përcaktojnë gjithashtu se nëse legjislacioni vendas nuk arrin të përbushë standardin e kompensimit të BERZH-it, kostoja e plotë e zëvendësimit, kompensimi sipas ligjit të brendshëm duhet të plotësohet me masa shtesë për të përbushur standardin e vendosur. Nëse në hartimin e këtij LPP (Plani i sigurimit të tokës) janë marrë masa shtesë, ato përmenden dhe shpjegohen qartë në LPP.

ÇPër rimbursimin e përdorimit të tokës në dy zonat Kadastrale të prekura nga Projekti i Rrugës, është marrë parasysh vlerën mesatare të transaksionit për shitblerje të pronave që kanë karakteristika të ngjashme me pronën në procesin e shpronësimit.

ÇPër rimbursimin e përdorimit të tokës në dy zonat Kadastrale të prekura nga Projekti i Rrugës, është marrë parasysh vlera mesatare të transaksionit për shitblerje të pronave që kanë karakteristika të ngjashme me pronën në procesin e shpronësimit.

Identifikimi i statistikave zyrtare për pjesë të produkteve bujqësore. Kompensimi i tokës: Në përcaktimin e vlerës së kompensimit për njësi të tokës bujqësore merren parasysh metodat aktuale të vlerësimit të efektit të kompensimit, të dhënat e disponueshme për transaksionet e shitjes së tokës bujqësore, aktet ligjore në fuqi të nxjerra nga Qeveria Shqiptare për shpronësimet për interes publik, çmimin për njësi të shpronësimeve për interes publik të kryera në zonën përkatëse, si dhe mostra të veçanta për këtë qëllim në dokumentet zyrtare të BERZH-it. Në

përgjithësi, qëllimi kryesor ishte propozimi i një çmimi për njësi për sipërfaqen e kompensimit duke reflektuar vlerën e tregut/vlerën e zëvendësimit të tokës në të cilën do të ndërtohet rruga.

2.4 Për auditimin e prokurimit të fondeve të kredisë si dhe ndjekjen e procedurave të Vlerësimit dhe Kontraktimit të fituesit, kontrata e punimeve civile me referencë DTM50123/W/2020/1 datë 07.12.2020 me OE A. në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, Projekti Rikonstruksioni i rrugës së Uji i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy Bypass – ve)

Në zbatim të pikës 4 të Programit të Auditimit nr. 265/2 prot, datë 11.03.2022, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Ligji nr. 54/2018 datë 23.07.2018 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale”;
- Ligji nr. 44/2020 datë 23.04.2020 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri”;
- Manuali i procedurave të prokurimit sipas udhëzimeve të donatorit;
- Manuali i Operimit të Projektit;
- Dosja e procedurës së prokurimit;
- Korrespondenca të ndryshme;

Projekti “Konektiviteti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale” është një Projekt i cili ka parashikuar ndërhyrje në rrjetin rrugor rajonal në zona me potencial bujqësor dhe turistik në të gjithë vendin dhe financohet nga Banka Botërore dhe BERZH me vlerë 100 milionë USD.

Për procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt **“Rehabilitimi i rrugës Vlorë-Orikum” 10.6 km EBRD/RLRCP/W/2020/1.)**

Procesi i prokurimit me të dhëna dhe hapat kryesore është dhënë në tabelën si më poshtë:

Plani i Prokurimit: Kontrata RLRCP/1/1.9/2018 “Projekti i Konektivitetit të Rrugëve Lokale dhe Rajonale” P163239. Huaja Nr. 8850-AL Banka Botërore.			
Përmbajtja	Planifikuar	Rishikuar nga Banka	Statusi aktual
Ftesa para-kualifikim	Shkurt 2020	25 Shkurt 2020	25 Shkurt 2020
Afati parakualifikimit	20 Mars 2020	27 Mars 2020	27 Mars 2020 Amenduar 03 Prill 2020
Vlerësimi pa-kusht i para-kualifikimit	20 Prill 2020		24 Korrik 2020
Kategoria:	Punime civile		
Metoda e zgjedhjes së prokurimit:	1 fazë e vetme me para-kualifikim të cilësisë		
Qasja e tregut:	I hapur		
Rishikim i Bankës (No-Objection) Përpara/Pas:	Përpara		
Kosto e vlerësimit fillestar (pa TVSh)	14,036,939 US\$		7,228,538.85 US\$
Specifikimet Teknike	24 Shkurt 2020	25 Shkurt 2020	25 Shkurt 2020
Hapja e Tenderit	20 Prill 2020	04 Shtator 2020	22 Tetor 2020 ora 10:00
Vlerësimi i tenderit	20 Korrik 2020		28 Nëntor 2020
Njoftimi për dhënien e kontratës (Letër Pranimit)	20 Korrik 2020		

Nënshkrimi i kontratës	20 Korrik 2020		07 Dhjetor 2020
Shtesë Kontrate(VO 1)			

-Njoftimi për kërkesën e ofertës:

Për kryerjen e prokurimit është përdorur procedurë e hapur konkurrimi me një fazë të vetme me para-kualifikim dhe kontroll të cilësisë, konform rregullave të prokurimit të Bankës 1 Shtator 2019.

Njoftimi për para-kualifikimin është publikuar në web-site e Bankës në datën 25 Shkurt 2020, si edhe afati për dorëzimin e dokumenteve për ishte vendosur më 27 Mars 2020. Ndërkohë, afati përfundimtar (dead-line) ishte amenduar në 03 Prill 2020. Sipas publikimit për para-kualifikim, ishin regjistruar në system on-line 23 aplikantë nëpërmjet sistemit ECEPP të Bankës. Në seksionin e IV të Përshtatshmëria dhe Kriteret e Vlerësimit, pikat 4,1,4.2,4.3, ishin parashikuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta, të cilat janë përdorur për vlerësimin paraprak dhe të cilësisë. Në kriteret e kualifikimit janë përfshirë si më poshtë:

- Kriteret e përshtatshmërisë ligjore,
- Kontratat e parealizuar;
- Situata dhe performance financiare;
- Eksperienca e menaxhimit;
- Eksperienca specifike;
- Eksperienca ESHS etj.

-Vlerësimi i ofertave:

Ftesa për tender ishte publikuar në xheb-site e Bankës në datën 04 Shtator 2020. Në Raportin e Vlerësimit datë 28 Nëntor 2020, janë vlerësuar 10 aplikantë dhe janë refuzuar 2 aplikantë të tjerë, të cilët nuk kishin prezantuar garancinë bankare për sigurimin e ofertës. Konkretisht kanë paraqitur ofertë OE si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta
1	A.ñ T. ñ S.	7,228,538.85
2	S.	7,908,530.68
3	S. E.ñ E.& C. - S..	7,909,211.11
4	G. L. G. T. A. C. C.W.L.L	8,289,360.69
5	C. G. C. C. K.S.C	8,657,865.54
6	A. S. ltd	9,634,057.70
7	JV T. E. 2 & S. A.	9,877,379.25
8	JV G. ltd & G. C. ltd	9,976,890.98
9	G. ltd	10,500,466.36
10	S. C. L.	10,813,449.24

Komisioni i Vlerësimit ka rekomanduar lidhjen e kontratës me ofertuesin óA.ñT.-S.ô, Bullgari, për çmimin e tenderit 7,228,538.85 US\$, pa TVSh.

Për sa më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr. 4, datë 29.04.2022

2.5 Mbi zbatimin e kontratës së lidhur për mallra, shërbime dhe punime përfshirë verifikimin dhe inspektimin në terren të kontratës për segmentin “Rikonstruksioni i Rrugës Uji i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy By – pass – eve” me mbikëqyrës të punimeve BOE “P.&E.”, kontrata me referencë DTM50123/W/2020/4, datë 28.12.2020 me vlerë 986,160 \$ me TVSH.

Në zbatim të pikës 4 të Programit të Auditimit nr. 265/2 prot, datë 11.03.2022, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Ligji nr. 54/2018 datë 23.07.2018 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale”;
- Ligji nr. 44/2020 datë 23.04.2020 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri”;
- Manuali i procedurave të prokurimit sipas udhëzimeve të donatorit;
- Manuali i Operimit të Projektit;
- Dosja e procedurës së prokurimit;
- Pagesa pjesore;
- Korrespondenca të ndryshme;

Titulli i gjetjes:	Ekspozimi i FSHZH ndaj riskut të paraqitjes së ankesave nga ana e kontraktorit për vonesa në kryerjen e pagesave sipas kushteve të kontratës.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se aktualisht, pas lidhjes së kontratës nga ana e kontraktorit është paraqitur për pagesë vetëm një situacion pjesor i gushtit të vitit 2021 i cili i takon pagesës paradhënie <i>Advance Payment</i> në shumën prej 1,445,707.77 USD pa TVSH, ose 1,734,849.324 USD me TVSH. Nga kjo i është paguar OE <u>vetëm pagesa e vlerës së TVSH në masën 30,258,663 lekë, ose vlera koresponduese e shumës prej 289,141.55 USD.</u> Pas ndryshimit të projektit fillestar të dorëzuar nga ana e projektuesit BOE I.&A.& S. C., rezulton se objekti nuk disponon akoma leje ndërtimi, nuk është dorëzuar sheshi i ndërtimit, punimet në terren nuk kanë filluar dhe janë ende në proces procedurat për shpronësimet. Aktualisht kontraktorit nuk i është paguar shuma prej 1,445,707.774, situatë kjo e cila e ekspozon ndjeshëm FSHZH ndaj riskut të paraqitjes së ankesave nga ana e Kontraktorit për vonesa në kryerjen e pagesës sipas kushteve të kontratës.
Kriteri:	Ligji nr. 44/2020 datë 23.04.2020 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri”, neni III Ekzekutimi i Projektit, pika 3.01, germa c dhe d, <u>ku përcaktohet se:</u> “Huamarrësi, përveç kur Banka bie dakord ndryshe: c) siguron që Enti Zbatues të përmbushë dispozitat e kësaj marrëveshjeje; d) ofron ose siguron ofrimin e të gjitha licencave, miratimeve apo pëlqimeve qeveritare që duhen siguruar për financimin dhe realizimin e Projektit dhe aktivitetet e tij, duke përfshirë, pas asnjë kufizim, të gjitha lejet dhe licencat e nevojshme për të garantuar të drejtën e kalimit dhe të drejtat e tjera të përdorimit të tokës për zbatimin e Projektit”
Ndikimi:	Ekspozimi i FSHZH ndaj riskut të paraqitjes për ankesave për vonesa në kryerjen e pagesave nga ana e kontraktorit rrit mundësitë e krijimit të situatave jo të favorshme për financat e Projektit dhe të vet FSHZH.
Shkaku	Mungesa e ndjekjes në mënyrën e duhur të hapave për realizimin e projektit nga ana e FSHZH, konkretisht të atyre në drejtim të bashkëpunimit me

	Bashkinë Vlorë për identifikimin e saktë dhe në kohë të gjurmës së projektit.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga ana e FSHZH, në zbatim të Nenit III Ligji nr. 44/2020 datë 23.04.2020 dhe në cilësinë e <i>Entit Zbatues të Projektit</i> të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar një menaxhim të konsoliduar financiar me qëllim përmbushjen e dispozitave të kësaj marrëveshjeje.
Afati:	<i>Menjëherë dhe në vijimësi.</i>

Me shkresën nr. 789/10, datë 20.05.2022 (prot në KLSH me nr. 265/5 prot., datë 23.05.2022) FSHZH ka paraqitur observacionet për projektraportin e auditimit, ku pretendoni se: Referuar ligjit nr. 44/2020 datë 23.04.2020 “Për ratifikimin e marrëveshjes” në seksionin 1.02 “Kërkesat e performancës” të maj 2014 në lidhje me politikat mjedisore. Duke qenë se marrëveshjet e nënshkruara nga shteti shqiptar prevalojnë mbi ligjet vendase. Listohen një sërë dokumentash komunikimi zyrtar me Bashkinë. Publikimet në faqen e internetit të Bashkisë dhe FSHZH. Kontakti kryesor për të adresuar kërkesat dhe sygjerimet e palëve të interesit ka qenë Bashkia Vlorë.

-Me shkresën nr. 116, datë 13.05.2022 është caktuar kordinaori për të drejtën e informimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në komentet dhe spjegimet tuaja nuk keni sjell dokumentacion shtesë të cilat nuk janë shqyrtuar nga grupi i auditimit në kohën kur grupi zhvilloi fazën e auditimit në terren.

Ju sqarojmë se midis marrëveshjes së financimit dhe ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” nuk ka asnjë kontraditë dhe si i tillë ligji i marrëveshjes së financimit nuk prevalon mbi ligjin nr. 146/2014 dhe FSHZH nuk përjashtohet nga zbatimi i këtij ligji pasi është institucion që menaxhon paranë publike.

Komunikimi i vijueshëm me Bashkinë nuk tregon se dëgjuesat janë kryer por ju në çdo komunikim ja kaloni disa kompetenca bashkisë dhe bashkia juve. Nuk mundet që një marrëveshje e lidhur me bashkinë të ketë fuqinë e ligjeve dhe nuk shikohet që palët nuk respektojnë detyrat sipas marrëveshjes atëherë kjo marrëveshje e humbet efektivitetin e saj, pasi qëllimi i lidhjes nuk arrihet.

Publikimet që ku keni bërë në rrjetet sociale janë mbi mbledhje të zhvilluara me bashkinë edhe jo dëgjesa publike dhe të publikuara pas faktit.

Kordinatori për të drejtën e informimit të bëhet publik në faqen zyrtare dhe të përshkruhen detyrat e tij.

Periudha e auditimit ka qenë deri në 28.02.2022.

Nuk janë sjell argumenta shtesë.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion në lidhje me dëgjesa publike rezulton një listë me pjesëmarrës për takimin e zhvilluar në Bashkinë Vlorë datë 16.07.2020 me 14 pjesëmarrës dhe takimi është institucional pasi ka vetë pjesëmarrës nga institucionet Bashkia Vlorë dhe FSHZH dhe vetëm 2 pjesëmarrës nga fusha e biznesit.

Nga FSHZH në lidhje me dëgjesat publike konstatohet se nuk janë kryer publikimet në regjistrin elektronik për konsultimet si dhe publikimi në programin e transparencës. Nuk ka një bazë të dhënash mbi procesin e konsultimit publik. Pas kërkesave të kryera nga grupi i auditimit nuk u vendos në dispozicion një informacion i qartë dhe i detajuar mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.

Për takimet e zhvilluara, që gjithsesi nuk mund të klasifikohen si dëgjesa publike, nuk ka procesverbale për dokumentimin e diskutimeve dhe pretendimeve të ngritura nga palët në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet nr. 17-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: FSHZH në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë të marrin masa të organizojnë konsultimet publike për rikonstruksionin e rrugës Ujë i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy By në Pass^{ve}, pjesë e projektit Konektiviteti i rrugëve rajonale dhe lokale me të gjitha etapat e parashikuara nga kuadri ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2 Rekomandimi: FSHZH në bashkëpunim me institucionet përfituese të projekteve të marrin masa që të kryejnë konsultimet publike me të gjitha etapat e parashikuara në kuadrin ligjor me qëllim që projektet të jenë të pranueshme nga komuniteti si dhe mos të ketë vonesa gjatë implementimit të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se FSHZH nuk ka caktuar një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik për bashkërendimin dhe administrimin e punës.

Nuk u vendos në dispozicion asnjë provë dokumentare mbi publikimin e njoftimit të konsultimit publik, marrjen e komenteve dhe rekomandimeve në asnjë formë.

Nuk dokumentohet si janë njoftuar palët e interesit mbi arsyet dhe ndikimin që ka projekti, afati, vendi dhe mënyra se si mund të dërgohen rekomandimet, adresa e kontaktit të koordinators për njoftimin dhe konsultimin publik në kundërshtime me nenet 10, 11, 13 të ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet nr. 17-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: FSHZH në bashkëpunim me institucionet përfituese të projekteve të marrin masa që të ngrejné strukturat përkatëse për zhvillimin e konsultimeve publike duke mirë informuar palët e interesit dhe duke reflektuar dhe zgjidhur problematikat e komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Deri në fund të periudhës objekt auditimi (datë 29.04.2022) nuk ka një projekt përfundimtar të pranuar dhe miratuar nga FSHZH (zhvillues i projektit) dhe Bashkia Vlorë (përfitues) por ka një projekt që është në proces ndryshimi ku është evidentuar një gjurmë dhe një listë me prona që preken nga projekti. Në raportin e hartuar nga vlerësuesja e pasurive të paluajtshme zj. M. F. janë evidentuar pronat dhe vlera koresponduese për shpronësim. Impementimi i projektit óRikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë ñ Oriku dhe ndërtimi i dy By ñ Pass^{ñeve} prek pronat e Bashkisë Vlorë në zonat Kadastrale 8602 (Vlorë) dhe 3140 (Radhimë), Njësia Administrative Oriku. Për të minimizuar efektet e shpronësimit, ndërtimi i rrugës, që do të mundësohet nga zbatimi i projektit, ka bërë të mundur shmangien e pronave private të zëna nga ndërtesa banimi dhe/ose objekte biznesi aty ku ka qenë teknikisht e mundur. Kuadri ligjor në fuqi për zbatimin e projektit parashikon që personat e prekur nga projekti do të kompensohen për çdo humbje të aseteve fizike, të ardhurave dhe fitimeve që rrjedhin nga realizimi i këtij investimi, nëse këto humbje janë të përkohshme ose të përhershme. Megjithatë, dëshmitë e mbledhura nga vizitat në terren kanë treguar se ndërtimi i rrugëve prek kryesisht parcelat në pronësi publike, tokat bujqësore, vegjetacionin dhe prodhimin në këto toka. Zbatimi i projektit do të ndikojë drejtpërdrejt tek personat që preken nga projekti sepse do të shpronësohen për një sipërfaqe të caktuar të pronës së tyre. Shpronësimi kryhet për interes publik dhe toka bujqësore e marrë do të përdoret për ndërtimin dhe vënien në funksion të objektit “Rikonstruksioni i rrugës ekzistuese Vlorë-Oriku dhe i dy By-pass^{ñeve}”.

Në sipërfaqen 47 311.14 m² janë marrë në konsideratë sipërfaqja 15 695.44 m² - By Pass 1 dhe 31 615.70 m² By Pass2. Nga vlerësimi i kryer deri në këtë pikë të projektit rezulton se në total nga ndërtimi i dy By-Pass^{ñeve} preken 50 prona, specifikisht 22 prona nga By ñ pass 1 dhe 28 prona nga By ñ pass 2.

Aneksi nr. 3.2 óLista e pronave që preken nga projekti dhe që do të shpronësohenó

Kosto totale e shpronësimit është 567,733,680 lekë ku përveç vlerës së tokës futen edhe kosto e produkteve bujqësore, si dhe zhvlerësimi i pronës nga shpronësimi i një pjese të saj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet nr. 31-34 të RaportitPërfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: FSHZH në bashkëpunim me të gjithë institucionet e përfshira në procesin e shpronësimeve të marrin masa që të evidentohen lista e plotë e pronarëve, vlera përkatëse dhe të nisin menjëherë hapat ligjor për përfundimin e procesit të shpronësimeve dhe kompensimin e pronarëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e punimeve civile në këtë segment është lidhur kontrata e punimeve me referencë DTM50123/e /2020/1 datë 07.12.2020 me OE óA.-M.ó me vlerë 8,674,246.62 USD me TVSH me afat 12 muaj ndërsa për mbikëqyrjen e punimeve është lidhur kontrata me BOE óP.&E.-Gó sipas kontratës me referencë DTM50123/e /2020/4 datë 28.12.2020 me vlerë 986,160 USD me TVSH. Aktualisht, pas ndryshimit të projektit fillestar të

dorëzuar nga ana e projektuesit BOE I.& A. 4 & S. C., projekti i ri nuk disponon akoma leje ndërtimi; nuk është dorëzuar sheshi i ndërtimit; punimet në terren nuk kanë filluar dhe janë ende në proces procedurat për shpronësimet. Në lidhje me ndryshimet e projektit nga ana e subjektit të audituar u vu në dispozicion dokumentacioni si më poshtë:

- Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 9879 prot., datë 15.11.2018 dhe në FSHZH me nr. 1518 prot., 20.11.2018, Bashkia Vlorë i është drejtuar FSHZH dhe projektuesit me një shkresë ku i ka përcjellë projekt në propozimet në lidhje me ndërtimin e dy Bypass^{inëve} në rrugën Radhimë në Orikum. Sipas këtij projekt propozimi është rishikuar gjurma e propozimit fillestar duke marrë parasysh parcelat ekzistuese, gjurmët e rrugëve ekzistuese, njësitë strukturore referuar PPV si dhe relacioneve shpjeguese. Sipas kësaj shkresë është cituar fakti se Bashkia Vlorë e ka bërë këtë projekt propozim në bashkëpunim me grupet e interesit, bizneset që operojnë në atë zonë, si palë të interesuara;

- Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 6131 prot., datë 22.07.2020 dhe në FSHZH me nr. 1635 prot., 24.07.2020 Bashkia Vlorë i ka kërkuar FSHZH rishikimin e projektit me qëllim reflektimin e projekt-propozimeve të bëra nga kjo NJV e cila sipas Bashkisë është kryer në bashkëpunim me grupet e interesit, bizneset që operojnë në atë zonë, si palë të interesuara;

- Me shkresën e administruar në FSHZH me nr. 2171 prot., datë 22.09.2020 i është bërë me dije Bashkisë Vlorë fakti mbi vonesat në drejtim të Planit të Veprimit të Risistemimit për rrugën Uji i Ftohtë në Orikum dhe ndërtimi i dy Bypass^{inëve}. Edhe pas një takimi të kryer në datë 16.07.2020 të kryer në Bashkinë Vlorë me përfaqësues të Bashkisë dhe komunitetit nuk ka asnjë rezultat mbi marrjen e titujve të pronësisë nga ASHK për këtë arsye është kërkuar një angazhim shtesë nga ana e Njesisë Vendore;

- Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 602/1 prot., datë 19.01.2021 dhe në FSHZH me nr. 342 prot., 22.01.2021, Bashkia Vlorë i ka kërkuar FSHZH rishikimin e projektit me qëllim reflektimin e projekt-propozimeve të bëra nga kjo NJV e cila sipas Bashkisë është kryer në bashkëpunim me grupet e interesit, bizneset që operojnë në atë zonë, si palë të interesuara duke kërkuar spostimin e gjurmës së Bypass në atë si dhe spostimin e rreth-rrrotullimit i cili sipas Bashkisë Vlorë është jo funksional. Kësaj shkresë i është bashkëlidhur edhe ankesa e bërë nga ana e nga një banori, prona e të cilit preket nga kalimi i gjurmës së projektit.

- Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 1899/1 prot., datë 19.02.2021 dhe në FSHZH me nr. 342/1 prot., 01.03.2021, Bashkia Vlorë i ka kërkuar FSHZH rishikimin e projektit me qëllim reflektimin e projekt-propozimeve të bëra nga kjo NJV e cila sipas Bashkisë është kryer në bashkëpunim me grupet e interesit si dhe pronarëve legjitimë në atë zonë duke kërkuar spostimin e gjurmës së projektit pasi ajo e miratuar aktualisht në momentin e shkresës ka qenë e tillë që sipas Bashkisë ndan në mes parcelat dhe sjell një kosto të madhe edhe për shpronësimin e tyre. Gjithashtu është përmendur fakti se rreth-rrrotullimi i parashikuar është jo funksional dhe nuk zgjidh trafikun e mjeteve. Kësaj shkresë i është bashkëlidhur edhe ankesa e bërë nga ana e një grupi banorësh të Radhimës, prona e të cilëve preket nga kalimi i gjurmës së projektit;

- Me shkresën e administruar në FSHZH me nr. 342/2 prot., datë 04.03.2021 është dorëzuar projekti nga ana e Projektuesit sipas kërkesave të bëra nga ana e Bashkisë Vlorë.

Sipas të gjithë dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe pretendimeve të subjektit të audituar rezulton se është aplikuar për leje ndërtimi por kjo leje nuk është miratuar akoma për shkak të problemeve me pronat dhe aktualisht disponohet vetëm një Draft i miratimit të lejes. (*Shiko Aneksin nr. 2.1*). Për rrjedhojë rezulton se prej mungesës së ndjekjes në mënyrën e duhur të

hapave për realizimin e projektit nga ana e FSHZH, konkretisht të atyre në drejtim të bashkëpunimit me Bashkinë Vlorë për identifikimin e saktë dhe në kohë të gjurmës së projektit janë shkaktuar vonesa në realizimin e projektit sipas marrëveshjes së financimit të ratifikuar me ligj. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 44/2020 datë 23.04.2020 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri”, neni III Ekzekutimi i Projektit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 35-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Nga ana e FSHZH, në zbatim të Nenit III Ligji nr. 44/2020 datë 23.04.2020 dhe në cilësinë e *Entit Zbatues të Projektit* të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme kryesisht ato në drejtim të bashkëpunimit me Bashkinë Vlorë, sipas Marrëveshjes së lidhur me këtë qëllim mes FSHZH dhe Bashkisë Vlorë në datë 30.04.2020.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se aktualisht, pas lidhjes së kontratës nga ana e kontraktorit është paraqitur për pagesë vetëm një situacion pjesor i gushtit të vitit 2021 i cili i takon pagesës paradhënie *Advance Payment* në shumën prej 1,445,707.77 USD pa TVSH, ose 1,734,849.324 USD me TVSH. Nga kjo i është paguar OE vetëm pagesa e vlerës së TVSH në masën 30,258,663 lekë, ose vlera koresponduese e shumës prej 289,141.55 USD. Pas ndryshimit të projektit fillestar të dorëzuar nga ana e projektuesit BOE I.& A. 4 & S. C., rezulton se objekti nuk disponon akoma leje ndërtimi, nuk është dorëzuar sheshi i ndërtimit, punimet në terren nuk kanë filluar dhe janë ende në proces procedurat për shpronësimet. Aktualisht kontraktorit nuk i është paguar shuma prej 1,445,707.774, situatë kjo e cila e ekspozon ndjeshëm FSHZH ndaj riskut të paraqitjes së ankesave nga ana e Kontraktorit për vonesa në kryerjen e pagesës sipas kushteve të kontratës. Për rrjedhojë rezulton se prej mungesës së ndjekjes në mënyrën e duhur të hapave për realizimin e projektit nga ana e FSHZH, konkretisht të atyre në drejtim të bashkëpunimit me Bashkinë Vlorë për identifikimin e saktë dhe në kohë të gjurmës së projektit është rritur ekspozimi i FSHZH ndaj riskut të paraqitjes për ankesave për vonesa në kryerjen e pagesave nga ana e kontraktorit duke rritur kështu mundësitë e krijimit të situatave jo të favorshme për financat e Projektit dhe të vet FSHZH.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 35-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Nga ana e FSHZH, në zbatim të Nenit III Ligji nr. 44/2020 datë 23.04.2020 dhe në cilësinë e *Entit Zbatues të Projektit* të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar një menaxhim të konsoliduar financiar me qëllim përmbushjen e dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

Menjëherë dhe në vijimësi

V. ANEKSE

Aneksi 2.1: Draft Projekt Vendimi mbi miratimin e lejes së ndërtimit të infrastrukturës: “Rehabilitimi i Rrugës Uji i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy By – Passeve”

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

PROJEKT - VENDIM

Nr.13, datë 17.03.2021

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS: “REHABILITIMI I
RRUGËS UJI I FTOHTË - ORIKUM DHE NDËRTIMI I DY BY-PASSEVE”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Bashkisë Vlorë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës: “Rehabilitimi i Rrugës Uji i Ftohtë - Orikum dhe ndërtimi i dy by-passeve”, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me zhvillues Bashkinë Vlorë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
EDI RAMA

MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU

DRAFT

ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
LEDIA TOTA

Aneksi nr. 3.2 “Lista e pronave që preken nga projekti dhe që do të shpronësohen”

BY-PASS-1 in CZ 3140

Nr.	Zona Kadastrale	Adresa Pasurie	Rrethi	Indeksi i Hartes	Nr. Pasurie	Sipërfaqe Shpronësimi (m ²)	Objekte (m ²)
1	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-B)	384/1	1834.2	
2	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-B)	385	192.01	
3	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-B)	427	202.48	
4	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-B)	390/2	512.62	
5	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-B)	391/16	961.92	
6	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-D)	391/4	962.7	
7	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-D)	391/2	432.22	
8	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-D)	391/1	979.5	
9	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-D)	402	1120.73	
10	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-D)	407	1883.35	
11	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-D)	408	1557.98	
12	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-D)	416	598.23	
13	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-D)	443	442.72	
14	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-D)	417/4	961.76	
15	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-D)	417/2	961.76	
16	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-D)	417/4	437.14	
17	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-D)	417/3	291.2	
18	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-D)	419/9	140.52	
19	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-D)	419/10	141.51	
20	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-D)	419/11	141.51	
21	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-D)	419/2	658.77	
22	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(224-D)	421	280.61	258.94

BY-PASS-2 in CZ 3140

Nr.	Zona Kadastrale	Adresa Pasurie	Rrethi	Indeksi i Hartes	Nr. Pasurie	Sipërfaqe Shpronësimi (m ²)	Objekte (m ²)
1	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-C)	142	882.66	
2	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-C)	145	539.91	
3	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-C)	311	273.12	
4	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-C)	144/1	151.68	
5	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-C)	144/2	106.02	
6	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-C)	144/3	190.16	
7	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-C)	144/4	176.92	
8	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-C)	144/5	64.88	
9	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-C)	149/1	1103.20	
10	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-C)	149/2	135.95	
11	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-C)	149/3	1721.97	
12	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-C)	149/4	512.57	
13	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-D)	149/9	460.54	
14	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-D)	149/10	508.92	
15	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-D)	149/11	406.08	
16	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-D)	149/12	863.27	
17	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-D)	149/15	513.76	
18	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-D)	149/16	832.44	
19	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-D)	157/5	630.86	
20	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-D)	157/3	410.12	

21	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(240-D)	160	5453.51	
22	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(256-B)	204/1	926.76	
23	3141	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(256-B)	204/2	1106.74	
24	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(256-B)	211/1	4087.12	
25	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(256-B)	211/3	1530.10	
26	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(256-B)	2	6068.18	
27	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(256-B)	5	494.91	
28	3140	Radhimë	Vlorë	K-34-123-(256-B)	505/1	1463.35	

Shkurtime

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
PMU	Njësia e Menaxhimit të Projektit
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës

KONTROLLI I LARTE I SHTETIT